

ANEKSI 2- ANALIZA DHE VLERESIMI I TERRITORIT

KAPITULLI I. ANALIZA E PERGJITHSHME E GJENDJES EKZISTUESE TE TERRITORIT 3

I.1. KLIMA	3
I.2. TOKA	3
I.3. SIZMICITETI	5
I.5. Uji i Pijshtëm	5
I.6. ZONA TË TRASHGIMISË KULTURORE	7

KAPITULLI II. ANALIZA E DOKUMENTAVE TË PLANIFIKIMIT TË HARTUARA MË PARË..... 9

II.1. PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË DURRËS	9
II.2. PLANI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT I KOMUNËS ISHËM (PZHT).....	11

KAPITULLI III. ANALIZA MJEDISORE12

III.1. ASETET KRYESORE TË ZHVILLIMIT MJEDISOR/NATYROR	12
III.2. KONKLIZIONE	13

KAPITULLI IV. ANALIZA E PROBLEMATIKWS MJEDISORE15

IV.1. NDOTJA E AJRIT	15
IV.2. NDOTJA E BURIMEVE UJORE	15
IV.3. MBETJETE NGURTA DHE NDOTJA E TOKËS	16
IV.4. POLITIKAT & INSTRUMENTET PER BURIMET MJEDISORE / NATYRORE.....	18
VI.5. KONKLIZIONE.....	20

KAPITULLI V. ZHVILLIMI RAJONAL.....21

V.1. ZHVILLIMI TERRITORIAL RAJONAL	21
V.2 TENDENCAT E BASHKËPUNIMIT RAJONAL	22
V.3. ZHVILLIMI RAJONAL SIPAS SEKTORËVE	24
V.3 KONKLIZION	25

KAPITULLI VI. ZHVILLIMI EKONOMIK.....27

VI.1. PREZANTIMI I PERGJITHSHEM I EKONOMISE SE BASHKISË DURRËS	27
VI.2. TE DHENA SEKTORET EKONOMIKE NE BASHKINË DURRËS	28
VI.3. TREGTIA	29
VI.4. AKOMODIMI& SHERBIMI USHQIMOR.....	30
VI.5. PRONËSIA E NDËRMARJEVE	31
VI.6 KONKLIZION.....	32

KAPITULLI VII. ANALIZA DHE VLERESIMI I PROBLEMATIKAVE SOCIALE34

VII.1. RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	34
VII.2. PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUARA, MOSHA E TRETE, DHE TE DREJTAT E FEMIJEVE.....	35

KAPITULLI VIII. ANALIZA E ZHVILLIMIT SOCIAL, PUNËSIMI, EDUKIMI, SHËNDETËSIA36

VIII.1. PUNËSIMI.....	36
-----------------------	----

VIII.2. EDUKIMI	38
VIII.3. SHËNDETI	40
KAPITULLI IX. DEMOGRAFIA.....	41
KAPITULLI X. STREHIMI	44
X.1. STOKU I STREHIMIT	44
X.2. BANESAT SOCIALE.....	45
KAPITULLI XI. INFRASTRUKTURA.....	47
XI.1. INFRASTRUKTURA RRUGORE & TRANSPORTI PUBLIK	47
XI.4. MENAXHIMI I MBETURINAVE	49
XI.5. FURNIZIMI ME UJË.....	50
XI.6. SISTEMI I KANALIZIMEVE	50
XI.7. HAPËSIRAT PUBLIKE DHE TË GJELBËRTA.....	50
XI.8. PLANET STRATEGJIKE PER SEKTORËT E INFRASTRUKTURËS.....	51
KAPITULLI XII. ANALIZA E PRONAVE PUBLIKE& MARRËDHËNIET E PRONËSISË MBI TOKËN	52
KAPITULLI XIII. ÇËSHTJET, ZONAT OSE OBJKTET E RËNDËSISË KOMBËTARE	55
KAPITULLI XIV. ANALIZA E ELEMENTËVE TË RËNDËSISHËM TERRITORIAL	57
XIV.1. POZITA E FAVORSHME GJEOGRAFIKE	57
XIV.1. POZITA E FAVORSHME PER ZHVILLIM NATYROR	57
KAPITULLI XV. ANALIZA E ELEMENTEVE PËRJASHTUES.....	59

KAPITULLI I. ANALIZA E PERGJITHSHME E GJENDJES EKZISTUESE TE TERRITORIT

Urbanizimi i shpejtë në Bashkinë Durrës ka çuar në zënien jo efikase të tokës urbane dhe konsumit të paqëndrueshëm të burimeve natyrore, duke krijuar presion të madh dhe rritje të densitetit të ndërtimit në qendër të NJA Durrës (veçanërisht në indet e qytetit historik) dhe të NJA Rrashbull në zonën e plazhit. Gjithashtu, është vënë re konsumimi i tokës së re bujqësore në zonat informale, me densitet të ulët si zona e Kënetës apo Spitallës. Ky zhvillim i pakontrolluar është i veshur me humbjen e hapësirave të gjelbërta dhe të hapura.

I.1. Klima

Durrësi ka një klimë tipike mesdhetare, me verë të lagësht dhe dimër të butë. Temperaturat mesatare variojnë nga rreth 5°C në janar dhe rreth 28°C në korrik dhe në gusht. Muajt më të nxehtë dhe më thatë të vitit janë qershori, korriku dhe gushti. Deti ndikon klimën e Durrësit duke mundësuar qarkullimin e masave ajrore të Atlantikut dhe të Mesdheut. Veprimtaria e njeriut, që në Durrës është shprehur me ndërhyrjet në natyrë si: tharja e kënetës, c'pyllëzimi në zonat kodrinore, ndërtimi i ujëmbledhësve apo ngritja e objekteve industriale, etj., ka kontribuar në tiparet klimaterike.

Erërat janë një element me rëndësi të madhe gjeografike dhe agrometeorologjike për ultësirën perëndimore. Erërat karakteristike për Durrësin janë brizat.

Gjatë verës në Durrës ka rreth 71 ditë me briza, kurse në dimër 18 ditë. Numri mesatar vjetor është 191 ditë. Në përputhje me motin briza fillon nga ora 9-10 paradite dhe vazhdon deri në 16-18 pas dite. Shpejtësia mesatare e saj në mesdite është 4-6 m/s. Erërat që ndihet në Durrës janë Murrai, Shiroku dhe Juga. Element tjetër i klimës janë vranësirat. Numri mesatar i ditëve të vranëta është 89.9 ditë/vit ndërsa ditë të kthjellta janë 110.6 ditë në vit.

I.2. Toka

Kushtet gjeologjike dhe geomorfologjike

Bashkia Durrës përfshihet në zonën Jonike, e cila karakterizohet nga depozitime që përfshijnë një diapazon kohor nga Triasi deri në ditët e sotme. Pjesa qendrore dhe perëndimore e zonës jonike e përfaqësuar nga Ultësira Joniano-Adriatike, në të cilën përfshihet edhe zona e gjerë e Durrësit. Në zone Peri-Adriatike takohen disa kodra, të cilat përfaqësojnë struktura antiklinale dhe disa zona të rrafshta që përfaqësojnë struktura sinklinale.

Ultësira ndërtohet nga depozitimet neogjenike, të cilat përfaqësohen nga shkëmbinj argjilore, alevrolite, konglomerate dhe ranore. Në NJA Durrës takohen dy struktura të rëndësishme gjeologjike: antiklinali i Durrësit dhe sinklinali i Spitallës të lidhur përkatësisht me kodrat dhe fushën e Durrësit. Një thyerje tektonike gjatësore aktive i ndan të dyja strukturat dhe është shkaktare e aktivitetit të lartë sizmik në këtë zonë. Pozicioni i saktë i thyerjes tregohet në hartën

gjeologjike. Antiklinali i Durrësit ndërtohet nga depozitimet e Miocenit dhe Pliocenit të cilët zhyten në lindje me kënde rreth 60° deri në 70°.

Kushtet dhe gjendja e Tokës


Kushtet e tokës në Bashkinë Durrës janë të lidhura ngushtë me të kaluarën e këtij qytetit si një qendër industriale ku dalloheshin industritë e plastikave, duhanit, kimikateve të ndryshme, etj.

Toka në Durrës ka karakteristika të ndryshme, si: tokë bujqësore; tokë ranore në bregun e detit; dhe toka e zonave industriale dhe ish industriale. Toka bujqësore në Bashkinë Durrës shtrihet në pjesën më të madhe të saj në NJA Durrës, në zonën e ish-kënetës dhe në atë të Shkozetit, ndërsa pesë NJA e tjera (Rrashbull, Sukth, Ishëm, Katundi i Ri, Manzë) për shkak të specifikave të tyre janë zona bujqësore.

Toka ranishte shtrihet përgjatë bregut të plazhit të Durrësit dhe në Currila (pjesërisht shkëmbore) si dhe në atë të Porto Romanos. Kjo tokë është po ashtu e kërcënuar nga ndërtimet por edhe nga erozioni. Zona e plazhit të NJA Durrës si dhe zona e plazhit e NJA Rrashbull e kanë tejkaluar kapacitetin e një zone turistike duke u shndërruar në lagje banimi.

Zonat industriale dhe ato ish-industriale në NJA Durrës krijojnë një presion të madh mbi tokën si nga pikëpamja e sipërfaqes po ashtu edhe nga pikëpamja e ndotjes. Në këto zona industriale gjenden edhe mjaft shtëpi banimi kryesisht me të ardhurit nga rrethet e tjera të vendit.

Figura 1. Harta gjendja e tokës (Burimi: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PPV Durrës.)




I.3. Sizmiciteti

Siç tregohet në Figurën 2, Bashkia Durrës konsiderohet si qendra e tërmeteve në Shqipëri, duke qenë se Durrësi shtrihet në një zonë me sizmicitet të lartë e njohur si zona pranë ultësirës së Adriatikut. Të dhënat sizmologjike për Bashkinë Durrës tregojnë së tërmetet e ndodhura në vite kanë qenë me intensitet të lartë dhe me rrezik për jetën e banorëve të Durrësit, gjë e cila duhet të mbahet parasysh nga autoritetet e ndërtimit, pasi mund të ketë pasoja tragjike. Tërmetet kanë qenë një nga faktorët që kanë ndikuar në ndërtimin e relievit të Durrësi t. Pasojë e këtij ndërtimi gjeologjik janë edhe pasuritë nëntokësore si qymyrguri (kryesisht në zonën e Manzës), etj.

Gjithashtu edhe të dhënat e sizmicitetit instrumental janë të tilla që përforcojnë faktin e rrezikut të lartë sizmik në Bashkinë e Durrësit. Përshpejtimi varion nga 0.2g në të gjitha territorin në 0.3-0.38g në pjesën jug dhe veri perëndimore të vendit.

Figura 2. Harta e shpërndarjes së epiqendrave të tërmeteve në Shqipëri

(Burimi: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PPV Durrës.)



I.5. Uji i Pijshëm

Durrësi furnizohet dhe nxjerr ujë të pijshëm nga burimet ujore të Fushë Kuqes. Një pjesë e madhe e sistemit ekzistues është përmirësuar, dhe uji i burimit është higjenikisht i sigurt. Kjo

bën që uji i pijshëm që vjen në rubinete të jetë i sigurtë. Përveç mangësive të infrastrukturës, edhe kapaciteti i burimit të ujit (Fushë Kuqe) është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat aktuale. Sipas llogaritjeve¹ të kryera si dhe duke supozuar humbje prej vetëm 15%, deri në 2020 deficit i ujit do të jetë rreth 30% të kapacitetit maksimal të prodhimit të burimeve.

Standardet evropiane për konsumin e Ujit të Pijshëm (Direktiva 11) janë 200 litra për banorë, pra teorikisht kjo shifër nuk mund të konsiderohet aspak e mjaftueshme sidomos po të kemi parasysh këtu që veç popullsisë rezidente shtohen edhe rreth 25000 turistë në ditë, me nevoja të më dha për ujë. Humbjet në rrjetin e ujit të pijshëm si rezultat i shpërndarjes, i ndërhyrjeve në rrjet, etj., janë afërsisht 15%. Këto humbje vijnë kryesisht si rezultat i lidhjeve ilegale në rrjet, lidhje të cilat rrisin mundësitë e ndotjes së ujit.

Rreth 80% e popullsisë furnizohet me ujë, dhe kohë zgjatja e furnizimit me ujë në ditë është mesatarisht 6 orë. Për më tepër 20% të fshatrave/lagjeve nuk kanë sistem furnizimi me ujë.


Pastërtia e burimeve të ujit të pijshëm po cenohet edhe nga ndotja e ujërave nëntokësore. Një shqetësim tjetër i madh është edhe ndotja e ujit të pijshëm si pasojë e rrjedhjeve nga kanalet e drenazhimit të ujërave të ndotura të qytetit. Gjithashtu në zonat rurale popullata përdor ujin e puseve, i cili duhet kontrolluar në mënyrë rigoroze duke pasur parasysh ndotjet e ujërave të cekta nëntokësore në zonën e Durrësit.

Figura 3. Harta e furnizimit me ujë (Burimi: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PPV Durrës.)



Figura 4. Harta Hidrologjike (Burimi: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PPV Durrës.)

¹Studimi i fizibilitetit për ujësjellësin e Durrësit dhe Kavajës, IC Konsulentin, 2008.



I.6. Zona të Trashgimisë Kulturore

Qyteti i Durrësit daton në shekullin e VII para Krishtit, në vitin 627. Qyteti modern është ndërtuar mbi rrënojat e Epidamit ose Dyrrachion-it të lashtë, që më vonë u transformua në Dyrrachium-in e periudhës romake. Godinat më të mëdha u ndërtuan në Dyrrachium gjatë shekujve të I - II pas Krishtit.

Durrësi është një qytet me kulture të hershme, për vete origjinën e tij të lashtë. Qyteti ka trashëguar mjaft vlera të së kaluarës, qendra historike dhe arkeologjike si Amfiteatri, Rrethoja Bizantine, Torra Veneciane, Muri rrethues i Kalasë, Vila Mbretërore, Kulla e Vrojtimit por edhe qendra kulturore e fetare si rrënojat e Bazilikës në Arapaj, kështjella e Rodonit etj.

Në Durrës gjenden një rradhë muzesh dhe monumentesh si: Muzeu Arkeologjik, Muzeu Etnografik, Monumneti i Mujo Ulqinakut, Monumenti i Sabri Tucit, Mozaiku i Orfeut, Mozaiku i Bukuroshes së Durrësit etj.

Figura 5. Harta e Zonifikimit Arkeologjik të qytetit të Durrësit

(Burimi: Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PPV Durrës.)



Figura 5, më sipër, tregon se zona e arkeologjike në Bashkinë Durrës ndahet në zonën arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit sipas ndarjes së këtyre zonave, jepen dhe specifikimet teknike në lidhje me zhvillimin e tyre të cilat merren në konsideratë nga Pushteti Lokal në Durrës, gjatë kryerjes së investimeve në këto territore.

KAPITULLI II. ANALIZA E DOKUMENTAVE TË PLANIFIKIMIT TË HARTUARA MË PARË

Dokumentet e mëparshëm të planifikimit të territorit mbulojnë zhvillimin e NJA Durrës dhe NJA Ishëm, për të cilat ekzistojnë repsektivisht Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Durrës (sipas ndarjes së mëparshme territoriale) (PPV) dhe Plani i Zhvillimit të Turizmit, Komuna Ishëm (PZHT).

II.1. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Durrës

PPV i Bashkisë Durrës është miratuar në korrik të vitit 2013, dhe do të zëvendësohet sapo të hyjë në fuqi PPV e vitit 2016, e cila do të trajtoj bashkinë e Durrësit sipas ndarjes së re territoriale.

Ky plan analizon Durrësin në kuadrin rajonal; organizimin hapësinor; sistemin e transportit; infrastrukturën bashkiake; profilin social-demografik.

Në PPV 2013 evidentohen pesë vizione kryesore për zhvillimin e bashkisë, të cilët përkthehen në qëllime, ku për secilin qëllim vendosen një sërë objektivash, të cilat mbështeten nga programe të zhvillimit.

- Vizion 1: Durrësi duhet të zhvillohet si një qytet i dimensioneve dhe standarteve evropiane meqënëse i ka të gjitha potencialet dhe oportunitetet për të arritur këtë vizion;
- Vizion 2: Durrësi është qyteti i frontit ujqor të Adriatikut dhe forca e tij duhet të mbahet nga Master Plani i ri duke propozuar masa të përshtatshme planifikimi për të zhvilluar me harmoni ekologjike me tokën dhe detin;
- Vizion 3: Durrësi do të vazhdojë të jetë magnet për turizmin kombëtar dhe ndërkombëtar duke ruajtur identitetin e vet historik dhe duke siguruar kushte të mira jetese për qytetarët;
- Vizion 4: Durrësi mund të jetë qyteti i harmonisë dhe integritetit midis aseteve rezidenciale, industriale, SME-ve historike dhe natyrore ndërsa respekton dhe promovon imazhin e përgjithshëm të një qyteti port të Adriatikut;
- Vizioni 5: Durrësi do të jetë qytet i mobilitetit të lartë urban, që siguron një trafik të sigurtë për të gjithë përdoruesit dhe sidomos për këmbësorët dhe personat me aftësi të kufizuar, me sa më pak ndotje të ajrit dhe zhurma.

Qëllimet e përcaktuara në PPV 2013 janë:

- 1- Durrësi një qytet i rajonit mesdhetar dhe porta e Evropës: Durrësi në kryqëzim të aksit kryesor strategjik shqiptar të zhvillimit të Korridorit VIII është një oportunitet i jashtëzakonshëm për tu rilidhur me një aks ndërkombëtar. Aksi lidhet me metropolin e autostradës dhe hekurudhën ekzistuese dhe me një linjë metro. Korridori është vendi ku do të ketë një përqëndrim të madh investimesh si në sektoret industrial e komerciale dhe në ato terciare.

- 2- Durrësi është qyteti i frontit ujq të Adriaktikut dhe forca e tij duhet të mbahet nga Master Planit i ri dukevpropozuar masa të përshtatshme planifikimi për tu zhvilluar në harmoni ekologjike me tokën dhe detin.
- 3- Durrës mund te jete qyteti i harmonisë dhe integritit midis aseteve rezidenciale, industriale NMV-ve, historike dhe natyrore ndërsa respekton dhe promovon imazhin e përgjithshëm të një qyteti port të Adriatikut: Integrimi urban midis vendbanimeve të lashta dhe të vjetra me urbanizimin e tanishëm dhe me parkun e ri industrial dhe impiantin energjistik.
- 4- Durrësi do te jete qytet i mobilitetit të lartë urban, që siguron një trafik të sigurtë për të gjithë përdoruesit dhe sidomos për këmbësorët dhe personat me aftësi të kufizuar, me sa me pak ndotje te ajrit dhe zhurma.

PPV 2013 e sheh zhvillimin ekonomik për Durrësin të lidhur ngushtë me zhvillimin e sektorit të transportit, për shkak të afërsisë me akset kryesore të komunikimit Evropian dhe të brendshëm, dhe evidenton se ekonomia e qytetit dhe tregu i punës do të përfitonin nga projekte të tilla si zmadhimi i Portit të Durrësit dhe rehabilitimi i hekurudhës ekzistuese.

Ky plan e konsideron turizmin si një nga sektorët më premtues për zhvillimin ekonomik të këtij qarku; dhe vlerëson burimet ujore të qytetit, tokën dhe klimën e favorshme për zhvillimin e bujqësisë. Në të njëjtën kohë, PPV 2013 vlerëson se qyteti ofron shumë mundësi për punë sezonale të cilat shpesh janë informale dhe te pasigurta.

Gjatë jetëgjatësinë të shkurtër të PPV 2013 janë kryer investime kryesisht në drejtim të infrastrukturës së banimit jo në përputhshmëri me atë çfarë është miratuar.

Sugjerohet që plani i ri të shikojë zhvillimin e Bashkisë Durrës në dy drejtime kryesore, të cilat mbështeten ne objektiva si më poshtë:

- **Durrësi , platforme shkembimesh & nyje logjistike në shërbim të rajonit të Ballkanit dhe Evropës Jug-Lindore:**
 - o Përfshirja e Bashkisë Durrës në funksionin e vendimmarrësit ne krijimin e infrastrukturës të nevojshme për ndërlidhjen e korridoreve kryesore ne rajonin e Ballkanit dhe Evropës Jug-Lindore;
 - o Vitalizimi i poleve zhvillimore;
 - o Rigjenerimi i zonave Urbane dhe Industriale.
- **Durrësi atraktiv për investitoret e huaj dhe vendas & motorr i zhvillimit ekonomik në Shqipëri:**
 - o Inkurajimi i aktivitetit ekonomik të investorëve në përputhje me përparësit e zhvillimit ekonomik të Bashkisë Durrës;
 - o Bashkia Durrës, pike orientimi për investitoret.

II.2. Plani i Zhvillimit të Turizmit i Komunës Ishëm (PZHT)

Plani i Zhvillimit të Turizmit i Komunës Ishëm, i realizuar në vitin 2009, trajton profilin e komunës, potencialet dhe llojet e turizmit, strategjinë për zhvillimin e turizmit si dhe planin e veprimit për të arritur objektivat e vëna.

Plani i veprimit vlerëson si emergjent hartimin e një plani rregullues për Komunën e Ishmit/zonën bregdetare duke vlerësuar se në mungësë të një plani të tillë zhvillimi nuk do të jetë i qëndrueshëm, duke qënë se plani kombëtar dhe planet pjesorë nuk mjaftojnë.

Vendimi nr. 13 i Këshillit të Lartë të Territorit (tashmë i riorganizuar si Agjencia e Planifikimit të Territorit), i datës 4 korrik 2013 “Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor , Komuna Ishëm , Qarku Durrës”, përpos miratimit të IPV për Komunën Ishëm, ngarkon këtë komunë për zbatimin e vendimit.

IPV e Komunës Ishëm ka në vizionin dhe politikën e zhvillimit territorial të saj rritjen e kapaciteteve të shërbimeve mbështetëse ndaj turizmit, bujqësisë, si pjesë përbërëse e ultësirës perëndimore, rritjen e shërbimeve ekonomike te organizuara

Plane të tjera zhvillimor të Bashkisë Durrës janë renditur si më poshtë:

- Bashkia Durrës dhe Komuna Ishëm kanë një plan të aprovuar te territorit;
- Bashkia Durrës, Komuna Ishëm dhe Komuna Rrashbull kanë nje plan zhvillimi ekonomik zyrtar.
- Bashkia Sukth ka një analizë studimore mbi ekonominë dhe transportin.
- Vetëm Bashkia Durrës ka një plan lokal të menaxhimit të mbetjeve të aprovuar.
- Vetëm Bashkia Durrës ka një Vlerësim Strategjik Mjedisor;
- Bashkia Manëz ka përgatitur planin e rregullimit urban (perfshire dhe Landillin) por nuk e ka te aprovuar.

KAPITULLI III. ANALIZA MJEDISORE

III.1. Asetet Kryesore të Zhvillimit Mjedisor/Natyror

Pasuritë natyrore dhe mjedisore të Bashkisë Durrës përcaktojnë dhe kushtëzojnë cilësinë e jetës së banorëve. Këtu, mund të përmendet uji (deti, lumenjtë dhe rezervuarët e shumtë), toka (bujqësore, kodrinore dhe industriale), vegjetacioni (i egër dhe i kultivuar), dhe kafshët (kryesisht blegtoria e mbarështruar). Sektorë të tjerë të aktivitetit mbështeten në bujqësi (në Sukth & Katundi i Ri), peshkim (Durrës), menaxhim pyjesh (Ishëm & Manzë), turizëm (Durrës, Ishëm, Rrashbull), minerale (Manzë deri para disa vitesh), duke prodhuar përfitime të qenësishme për banorët.

Sfida e bashkisë së re qëndron në menaxhimin e qëndrueshëm të ketyre burimeve. Një strategji zhvillimi optimale për territorin duhet të ndërtojë një kuadër eficient për menaxhimin e zhvillimit socio-ekonomik ndërkohë që siguron mbrojtjen dhe funksionimin optimal të kontekstit mjedisor dhe natyror.

- *Pyjet.* Pyjet shtrihen në zonën e Manzës dhe të Ishmit ku rriten bime me gjelbërim të përhershëm dhe shkurret mesdhetare. Në këto pyje mbizotërojnë lisi, shkoza, frashëri, dëllënja dhe murrizi.
- *Burimet ujore.* Bashkia përshkohet nga Ishmi dhe Erzeni, si dhe ka rreth 17 rezervuare artificiale të shpërndarë në të gjithë territorin e saj.
- *Deti.* Shumica e ujit dhe plazheve të vijës bregdetare është e ndotur. Ndotja vjen kryesisht si pasojë e numrit të madh të ndërtimeve, mungesës së shërbimeve higjieno-sanitare në plazhet përkatëse, praninë e portit më të madh të vendit (rreziku për ndotjen e mjedisit nga transporti detar nga rrjedhjet e vajrave dhe e mbeturinave në det si hidrokarburet).
- *Mineralet.* Në Bashkinë e Durrësit egziston vetëm ish-miniera e qymyrgurit në Manzë e cila është mbyllur tashmë, megjithatë janë dhënë disa leje shfrytëzimi për bregun e lumenjve Ishëm dhe Erzen të cilët kanë impaktuar mjedisin në këto zona.
- *Biodiversiteti.* Durrësi ka biodiversitetin tipik të një zone mesdhetare. Habitatet gjenden në kodrat rreth qytetit, fushat dhe hapësirat e gjelbërta brenda qytetit, në bregdet, si dhe në detin Adriatik. Përgjatë bregdetit ranor të vendit ruhen një sërë ekosistemesh me rëndësi mesdhetare si: laguna bregdetare, duna ranore, delta lumenjsh, pyje hidrofil dhe hidro-higrofil etj. Në ujërat e detit Adriatik dhe ujërat e brëndëshme gjendet një faunë e pasur pararruazorësh dhe rruazorësh, që nga celenteratët e deri tek gjitarët e larte. Pjesa e faunës tokësore përfaqësohet me kafshë si: *Canis aureus* (fam. Canidae), lepur i egër, *Oryctolagus cuniculus* (fam. Leporidae) si dhe nga disa kafshë shtëpiake si lopë, derr, dele, dhi, etj. Amfibët dhe zvarranikët janë të shumtë dhe mund të përmendin bretkocën *Rana dalmatica*, gjarprin *Vipera ammodytes*, zhapinj të *Lacerta* spp. etj.

- *Toka & toka bujqësore.* Toka ka karakteristika të ndryshme si: tokë bujqësore, pyje dhe kullota si në Manzë dhe Ishëm, tokë ranore në bregun e detit si dhe tokën e zonave industriale dhe ish industriale. Sipërfaqja në administrim e tokës bujqësore nga Bashkia e re zë gati 37% të tokës bujqësore dhe 16% të tokës jo bujqësore (fondi pyjor, kullota etj) të qarkut të Durrësit.
- *Ndotja e ajrit.* Nga monitorimet e gjashtë-mujorit të parë të vitit 2012 (rreth 7,500 monitorime) cilësia e ajrit në Bashkinë Durrës është problematike, si pasojë e rritjes së grimcave PM 2.5 dhe PM 10. Faktorët që kontribuojnë janë: rritja e vëllimit të ndërtimeve, ngritja e pluhurit, lëvizja e automjeteve, në vende të caktuara, cilësia jo e mirë e rrugëve, shtimi i numrit të industrive, cilësia e keqe e karburanteve apo edhe djegia e mbeturinave në kontenierët në qytet, por edhe nga djegia e tyre në zonën e vendgrumbullimit të mbetjeve.
- *Ndotjet e rrezikshme.* Ndotjet më akute kanë të bëjnë me detin – vetëm në 2015 janë evidentuar disa raste kur bregu është ndotur nga vajrat e anijeve. Ndotje shumë vizive është dhe mbulesa me mbeturinave në brigjet e lumenjve dhe në zonat ku këta lumenj derdhen në det. Po ashtu depozita e Porto Romanos dhe depozitat e deritanishme të NJA-ve rrezikojnë të ndosin napat freatike për arsye të cektësisë së tyre.
- *Mbetjet e gurta.* Në qarkun e Durrësit llogaritet se një banor i tij “prodhon” 236 kg mbetje në vit, duke u bazuar në një popullsi prej 414,677 banorësh (përfshirë dhe rrethin e Krutës) kjo shumë arrin në 140,755 tonë në vit mbetje urbane. Një studim i mbështetur nga IFC ka përcaktuar ndërtimin e një landfilli bashkëkohor rajonal për Qarkun e Durrësit (Zona 16 e studimit, fshati Radë, NJA Manzë). Më datë 18.11.2014 Ministria e Mjedisit së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës kanë publikuar në website të Agjencisë së Prokurimit hapjen e thirrjes për oferta për dhënien me koncesion të Landfillit për Qarkun e Durrësit, referuar nenit 48 të ligjit 125/2013 “Për koncesionit dhe Partneritetin Publik Privat”. Sipas të dhënave të fundit, ky process ka ndaluar.
- *Materialet toksike.* Sipas të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në Bashkinë Durrës janë dhënë 18 leje për Grumbullim, Depozitim dhe Riciklim të mbetjeve toksike. Këtu mund të veçohen mbetjet plastike, vaji i përdorur, mbetjet portuale dhe skrapi.

III.2. Konkluzione

Elementi natyror kushtëzues për Bashkinë e Durrësit është uji. Deti (që lag të gjitha NJA përveç Manzës); lumenjtë e Ishmit dhe Erzenit (që përshkojnë të gjithë NJA-të përveç Rrashbullit), apo rezervuarët e shumtë të shpërndarë në të gjithë bashkinë, janë një pasuri e paçmueshme. Në shekullin e XXI ku priten ndryshime klimatike, uji konsiderohet si ari i zi, është paradoksale që me gjithë këto burime, Durrësi të ketë ujë mesatarisht 6 orë në ditë.

Nga ana tjetër këto ujëra preken nga ndotja, që prek direkt cilësinë e jetës dhe vetë jetën e banorëve. Ndotja e detit, e ujrave nëntokësorë, tharja dhe keq-menaxhimi i rezervuarëve, ndotja e lumenjve dhe dëmtimi i shtratit të tyre janë faktorë që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e territorit, në suksesin e bizneseve dhe në cilësinë e jetës së banorëve.

Bashkia ka në kompetencat e saj menaxhimin e pyjeve që përkojnë dhe me zonat ujë mbledhëse të disa rezervuarëve të mëdhenj në veri. Menaxhimi i tyre duhet të kryhet në funksion të menaxhimit të ujit. Po ashtu dhe menaxhimi i mbetjeve duhet të bëhet duke mbajtur në konsideratë ruajtjen e napave freatike.

KAPITULLI IV. ANALIZA E PROBLEMATIKWS MJEDISORE

Analiza e problemeve mjedisore në Bashkinë Durrës orientohet kryesisht në pesw drejtime të cilat janë vlerësuar si më problematike: a) ndotja e ajrit; b) ndotja e burimeve ujore; c) ndotja e tokës; d) menaxhimi i mbetjeve; dhe e) zonat me rrezik tw lartw rrwshqitje/pwrmbytje/erozioni.

IV.1. Ndotja e ajrit

Ndotja e ajrit është mw e ndjeshme në NJA e Durrësit, dhe nw zonwn e Plazhit gjatw periudhws se verws. Numri i madh i automjeteve qe përbëjnë dhe burimet ndotëse kryesorë të ajrit në qytetin e Durrës (autostrada Tirana Durrës dhe trafiku lokal kontribuojnene ndotjen e ajrit ne NJA Katundi i Ri , Sukth dhe Rrashbull). Amplifikimi i këtyre burimeve tw ndotjes ndodh nga cilësia jo e mirë e karburanteve, gjendja jo e mirë e rrugëve automobilistike në disa zona të Bashkisë, por edhe pasojë e një trafiku të rënduar nga automjete të vjetra (kryesisht gjatë stinës së verës). Faktor i rendesishem është dhe bllokimi i bregut te detit me ndertime te larta qe pengojne futjen e ajrit te detit ne qytet dhe pastrimin e ndotjes. Po ashtu mesatarja e gjelbërimit për banorë në Bashkinë Durrës është 3.2 m² gjelbërim (norma e tanishme kombëtare është 7 m² për person).

Keto probleme mund te trajtohen kryesisht sipas drejtimeve te meposhteme:

- kufizimi i lartesisë dhe planifikim urban i ballit te qytetit per te mundesuar korridore te levizjes se ajrit nga bregu ne brendesi te qytetit;
- organizimi i trafikut (rruge nje-drejtimshe, sheshe parkimi bashkiak jashte qytetit, rruge te ndaluara per qarkullim automjetesh, etj.) per te fluidifikuar dhe pakesuar trafikun e automobilave ne qender;
- permiresimi i cilesise se rrugeve ne qytet;
- vendosja e rrugeve/parkingeve me system pagese ne zonen e plazhit;
- rregullimi i hyrja/daljes ne autostrade te zones urbane KIS;
- shtimi i siperfaqes se gjelberuar ne qytetin e Durrësit.

IV.2. Ndotja e burimeve ujore

Burimet e ndotjes jane: a) porti per ndotjen ne det; b) mbetjet urbane dhe pesticidet / nitratat per ndotjen ne plazhet dhe lumenjte, perfshire dhe derdhjen e tyre ne det; c) vendet e pasigurta te hedhjes se mbeturinave si Porto Romano persa i perket ujrave nen-tokesore dhe zonave akuifere.

Zona e Durrësit është e pasur me ujëra të cekta nëntokësore. Për këtë arsye ato janë edhe lehtësisht të kërcënuara nga ndotja. Duke pasur parasysh të shkuarën e Durrësit si një zonë industriale në periudhën e qeverisë komuniste, kjo ndotje është edhe më shqetësuese. Ujërat e

cekta nëntokësore në zonën e Durrësit vijnë nga basenet e Ishmit dhe Erzenit. Këto ujëra kanë një përmbajtje të pH prej 7 deri 9 dhe janë të pijshëm. Rrjedhjet e mundeshme nga deponia e Porto Romano perbejne nje kercenim te vertete por qe planifikohet et eliminohet me ndertimin e deponise se re ne Manze.

Plazhet e Durrësi t vuajne nga tre faktore ndotjeje: a) afersine me portin dhe pasojat e nje trafiku te renduar maritime jo me larg se dy kilometra nga plazhi ne jug te qytetit: rreziku për ndotjen e mjedisit nga transporti detar vjen edhe nga rrjedhjet e vajrave dhe e mbeturinave të gjitha llojeve si ujëra të zeza, plastika, letra, qelqe, hidrokarbure, bojëra toksike; b) numrin shume te larte te pushuesve gjate muajvete veres (rreth 700,000 pushues cdo sezon); dhe c) mungesen e infrastruktures modern te mirembajtjes si pasoje e zhvillimit te eger urban te zones se plazhit numri i madh i ndërtimeve, mungesa e një sistemi kanalizimesh për ujërat e zeza dhe urbane.

Se fundmi, per shkak te pozites si pika derdhjes ne det te dy lumenjve te rendesishem te Shqiperise se Mesme, Durrësi pret dhe mbeturinat urbane dhe pesticide / nitrate qe Ishmi dhe Erzeni mbledhin gjate gjithë pellgut te tyre ujë mbledhes dhe i depozitojne gjate bregut te tyre dhe deri ne det.

IV.3. Mbetjeje ngurta dhe ndotja e tokës

Depozitimi i mbetjeve tw ngurta është nje nga ceshtjet me kritike te Bashkise Durrës. Pervec amortizimit te vend grumbullimi i Porto Romanos (zone qe është perdorur me pare per veprimtari kimike me rrezik te larte, tre NjA depozitojne mbetjet ne vend-ndodhje te “perkoheshme”. Deri në ndërtimin dhe vënien në funksionim të landfilli te Rades (Manez).

Ne Bashkine e re te Durrësi t per momentin mbledhja dhe depozitimi i mbeturinave urbane behet nga nje mori institucionesh: dy ndermarrje publike pastrimi, dy kompani private, dhe tre drejtori sherbimesh ne nivel njesie admisnitartive (shiko tabelen). Ish-Bashkia e Durrësit është Autoriteti kryesor përgjegjës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në qytetin e Durrësit. Ajo i kryen këto shërbime nëpërmjet dy Ndërmarrjeve të saj të Shërbimeve Komunale: 1) Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës (NShKD), dhe 2) Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Plazh (NShKP). Të dyja ndërmarrjet drejtohen nga Këshilli Bashkiak dhe financohen nga buxheti i Bashkisë. Ato janë përgjegjëse për pastrimin e qytetit, grumbullimin e mbetjeve, dizinfektimin, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra, ndriçimin rrugor dhe varrezave publike, ofrimin e shërbimeve funerale, dekorin e qytetit si dhe planifikimin/monitorimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. është logjike dhe efciente qe keto dyndermarrje te ri-organizohen dhe mbulojne te gjithë territorin e bashkise se re.

Nw tabelwn e mwposhtme wshtw paraqitur situata aktuale e mbledhjes dhe depozitimit tw mbetjeve nw Bashkinw Durrws:

Mbledhja, Depozitimi i Mbetjeve ne Bashkine Durrës

NjQV	Menyra e Mbledhjes / Pastrimit	Depozitimi
NjA Durrës	Bashkia Durrës ka 2 ndërrmarje pastrimi: NSHK Durrës për zonat qyteti Durrës+Spitalle dhe NK Plazh për zonat Plazh+Shkozet.	VGM e Porto Romanos e miratuar vite më pare me vendim të këshillit bashkiak dhe prefekturës Durrës
NjA Manëz	E kryen vetë menaxhimin e mbetjeve, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve	Verçok / Ish Miniera Manez, Bashkia Manez
NjA Sukth	50% e kryen vetë Bashkia nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve dhe 50% shoqëri private e nënkontraktuar - AFA Group	Vardardhë, Bashkia Sukth
NjA Rrashbull	E kryen vetë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve.	Porto Romano, Durrës
NjA Katund i Ri	E kryen grumbullimin dhe transportin e mbetjeve me shoqëri private të nënkontraktuar DU&CO shpk	Porto Romano, Durrës
NjA Ishem	E kryen vetë menaxhimin e mbetjeve, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve	Kthesa e Rrotullës, Komuna Ishem

burimi: Agjencia Rajonale Qarku Durrës

Qarku i Durrësit ka përgatitur PRMM të tij, por ai nuk është miratuar ende nga Këshilli i Qarkut. Objektivat e përcaktuara në këtë PRMM për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në Rajonin e Durrësit janë: a) të bëhet grumbullim i diferencuar për 20% të mbetjeve brenda 4 viteve që nga miratimi i Planit; b) të bëhet grumbullim i diferencuar për 30% të mbetjeve brenda 7 viteve që nga miratimi i Planit, dhe c) të bëhet grumbullim i diferencuar për 50 % të mbetjeve brenda 10 viteve që nga miratimi i Planit. Nga komunikimet e deritanishme zyrtare nuk kemi informacion zyrtar nga Këshilli i Qarkut Durrës rreth hartimit të Projekt planit rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Po ashtu vetëm Bashkia e Durrësit ka nje *Plan Lokal te Menaxhimit te Mbetjeve* (PLMM) – asnje nga pese njesite e tjera nuk ka nje te tille.

IV.4. Politikat & Instrumentet per Burimet Mjedisore / Natyrore

Burimet natyrore mund te trajtohen nenkend-veshtrimin ekonomik dhe jo-ekonomik. Nen kendveshtrimin e *instrumenteve ekonomik*, ato konsiderohen si asete me nje vlere te caktuar qe menaxhohen duke maksimizuar te ardhurat nga to. Disa nga instrumentet ekonomike me te pershtatshem per Bashkine Durrës jane te drejtat e pronesisë, krijimi i tregjeve, instrumentet fiskale dhe mekanizmat e demshperblimit. Disa sugjerime per nje qasje ekonomike te burimeve mjedisore dhe natyrore te Bashkise se Durrësi t jane permblodhur ne tabelen e meposhtme:

Instrumentet Ekonomike & Aplikimi i Tyre					
	Te Drejtat e Pronesisë	Krijimi i Tregjeve	Instrumente Fiskale	Sisteme Kostosh	Instrumente Financiare
Pyjet	pronesia bashkiake	ndertimi i koncesioneve	taksat dhe tatimet		ndihme per ripyllëzim
Burimet Ujore	te drejtat mbi ujin	ndarja e perdorimit te ujit		Vendosja e cmimit te ujit gjoba per mbrojtjen e ujit	
Deti		te drejtat e peshkimit & aktoret			
Mineralet / Nentoka	te drejtat minerare		taksa dhe tatime		
Jeta e Eger		pagesat per akses (studim / gjueti/ etc)			
Bio-diversiteti	te drejtat e hulumtiveve / kerkimeve			pagesa per turizem shkencor	
Ndotja e Ujit		Marketimi i lejeve te derdhjes se ujit te ndotur	gjoba ndotje	pagesa per trajtimin e ujit	kredi me interes te ulet
Toka & Toka Bujqesore	te drejtat mbi token / mbi perdorimin e saj		taksa e pasurise / perdorimit		ndihma per te mbrojtur token e bukes

Ndotka e Ajrit		marketimi i lejeve te emisioneve	gjoba ndotje per	Ndihmese per teknologji pastrimi / kredi me interes te ulet	
Mbetjet e Rrezikshme				pagese per mbledhjen	
Mbetjet e Ngurta				Ndihmese per teknologji pastrimi / kredi me interes te ulet	
Materialet Toksike			taksime ne varesi te toksiciteit		
Klima	te ardhurat mbi emisionet e demshme detyrimet mbi mbrojtjen e pyjeve	marketimi i kuotave & lejeve per CO2 marketimi i rezervimit te karbonit	taksa e karbonit / BTU		
Vend-banimet njerezore (Human settlements)	pronesia mbi truallin	treg per kuotat e ndertimit / lejet e zhvillimit / etc	taksa e pasurise / perdorimit	Pagese per permiresim / zhvillim / perdorim / per perdorim te rrugeve	

Instrumentet jo-ekonomike përfshijnë:

1. *Pjesemarrjen publike*: kjo pjesemarrje është e sanksionuar me ligj, por nuk duhet bere vetem per kete shkak. Implikmi real i banoreve ne tematika qe prekin direct mireqenien e tyre është kusht per qendrueshmerine e cdo politike zhvillimore. Konventa mbi Diversitetin Biologjik jep shembuj te ndryshem si psh CBD VII/12; Udhezimet e Adis Abeba mbi komponentin e perdorimit te qendrueshem te biodiversitetit; CBD VII/14 udhezimet mbi zhvillimin e qendrueshem te turizmit; dhe CBD VII/16 Akëe, mbi udhezimet vullnetare mbi kryerjen e vleresimeve kulturore, mjedisrore dhe sociale per politika zhvillimore ne vende te shenjta, siperfaqe dhe ujë ra tradicionalisht te perdorura nga popullata indigjene, etj. Zhvillimi i politikave te bazuara ne keto rregulla, është i rekomandueshem.
2. *Edukimin*: qasja ne informacion dhe edukimi i banoreve pervec se e drejte njerezore baze, është gjithashtu dhe ne instrument qe lidh analizen ekologjike me sfidat e shoqerise. Si i tille ai është strategjik ne procesin e vendimmarrjes qe prek zhvillimin e territorin ne fjale. Vlen te permendet dhe roli qe duhet te kene grate dhe komunitetet e marginalizuara.

VI.5. Konkluzione

Problemi me urgjent mjedisor ne Bashkine e Durrësi t është depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve te ngurta. Depozita e Porto-Romanos është kthyer ne nje bombe me sahat jo vetem pwr shkak tw saturimit tw kapacitetit maksimal, por mbi te gjitha nga rrjedhjet dhe ndotja e napes freatike. Ne kete kontekst zgjidhja e depozites se re te mbetjeve te ngurta është urgjente dhe strategjike.

Gjithashtu, wshte shume e rendesishme vleresimi i pasojave te ndertimeve egzistuese ne zonat me rrezik te larte. Termetet, rreshqitjet e dheut dhe erozioni mun dte shkaktojne katastrofa natyrore me pasoje tragjike ne njerez dhe pasuri.

KAPITULLI V. ZHVILLIMI RAJONAL

V.1. Zhvillimi territorial rajonal

Durrësi wshtw i shtrirw pwrgrjatw bregut tw detit Adriatik, është porti kryesor dhe qyteti i dytë mw i madh nw vend, si dhe nje qender e rendesishme ekonomike dhe turistike e permasave nderkombetare. Toka midis këtyre dy qyteteve pergjate autostrades Tirane – Durrës është korridori kryesor i zhvillimit ne vend ku ndodhen jo vetem aktivitete dhe sherbime te reja industriale e tregetare por edhe shtepite e dhjetra mijwra te ardhurve nga qytete të ndryshme të Shqipërisë te vendosur ne kete zone.

Kufijte tokesore jane me rrethin e Tiranës dhe Krujë s ne lindje dhe verilindje dhe me rrethin e Kavajes ne jug dhe juglindje.

Bashkia Durrësit² është pjese e Qarkut te Durrësi t dhe perbehet nga 6 njesi administrative (NJA): Durrës, Sukth, Ishëm, Katund i ri, Rrashbull dhe Manëz. Ne perberje te tyre keto NJA perfshijne gjithsej 3 qytete dhe 40 fshatra (si dhe gjashte rajone dhe 14 lagje per Durrësi n).Nga pikepamja fizike, territori i bashkise karakterizohet nga nje terren bujqesor ne pjesen me te madhe, ku mbizoterojne fushat e Katundit te Ri, Sukthit dhe Manzes. Permes këtyre fushave kalon lumi Erzen, i cili sherben edhe si kufizues midis njesive administrative Sukth dhe Katund i Ri. Ne pjesen veriore dhe lindore territoret fushore kufizohen me vargun kodrinor te Manzes dhe Ishmit, me nje lartesi te ulet deri ne 269 metra mbi nivelin e detit, te cilat pozicionohen si kurore natyrore e gjirit te Lalezit.

Bashkia Durrës, aktualisht paraqitet si territor me karakter tw dukshem monocentrik. Ketu vihet re ekzistenca e një qendre të madhe rajonale me një prurje të fortë të banorëve të rinj. NJA Durrës se bashku me rrethinat është shumë e rëndësishme për te gjithë zonen si qender ekonomike. Por, ndërkohë që qendra rajonale është shumë e fuqishme, ka gjithashtu nën-qendra më të vogla të cilat shërbejnë si një qendër lokale për zonat rurale përreth.

Njësitet administrative lidhen me qytetin e Durrësit nëpërmjet shkëmbimeve me natyrë vendimtare si punësimi, edukimi dhe shëndetësia, dhe ndajnë të njëjtin territor të vazhduar. Pese prej tyre (Durrës, Sukth, Ishëm, Katund i Ri, Rrashbull,) shtrihen direkt në bregdet dhe menaxhojnë një pjesë të bregut duke ndarë interesa të përbashkëta në zhvillimet infrastrukturore, urbane, mjedisore dhe industriale orientuar kryesisht drejt turizmit, tregtisë, industrisë fasone dhe asaj përpunuese, ndersa NJA Katundi i Ri dhe Rrashbulli kanë kontakt gjeografik direkt me qytetin e Durrësi t.

²Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” 31.07.2014

V.2 Tendencat e bashkëpunimit rajonal

Në qytetin e Durrësi t përqëndrohet 65% e popullates, nëse shtohet edhe qyteza e Rrashbullit, e cila nuk ka ndarje natyrore me pjesen jugore te Durrësi t, atehere në qytetin e Durrësi t përqëndrohet 78.4% e popullates se te gjithë Bashkise. Përqëndrimi i dyte më i madh urban është ne zonen qe perfshin Sukthin dhe Katundin e Ri.

Pavarësisht afërsisë që kanë NJA-të midis tyre nga analiza sipas dhënave të tabelave të mëposhtme rezulton se, nuk ka pothuajse fare shkëmbim mes NJA Durrës dhe pese NJA-ve të tjera. Më pak se 1% e qytetareve te NJA Durrës levizin drejt NJA-ve të tjera të Bashkisë. Gjithashtu, vihet re që Ishmi ka 0 (zero) levizje hyrese/dalese ne te kater NjA e tjera (vec Durrësi t). Pjesa tjetër e NjA-ve nuk kanë ndonjë shkëmbim te qenesishem mes tyre (pervec me Durrësi n).

Eshte po ashtu i rëndësishëm fakti qe Rashbulli varet pothuaj teresisht nga Durrësi (72,81%) persa i përkët punesimit, ndersa Xhafzotaj (NJA jashte bashkisë Durrës) është shume i rendesishem per punesimin e banoreve te Sukthit, Katundit te Ri dhe Rashbullit. Po ashtu Rashbulli afron mundesi punesimi vetem per 4.22% te residenteve te tij.

Tabela 1: Flukset hyrese - dalese nga gjashte njesite e bashkise Durrës

	Total	Vendi i punes													
		DUR RËS	IS HË M	KAT UN D I RI	MA MI NA S	MA NËZ	RR AS HB UL L	SHI JA K	SUK TH	XH AF ZO TAJ	KA VA JË	LE KA J	SH KO DË R	TIR ANË	VO RË
DUR RËS	23 25 4	21 49 6	*	24	22	21	77	*	9	219	97	512	4	761	12
ISHË M	232	31	193			*		*	*	4				4	
KAT UND I RI	699	224	/	268	4		12		*	147	*	27	8	9	*
MAN ËZ	457	54			12	315	*	26	16	34	*	*		*	*
RRAS HBUL L	1 681	1 224		4	*	*	71		5	246	21	19	*	86	5
SUKT H	1 463	173	*	*	*	7	8		528	697	*	46		4	*

	Total	Vendi i punes													
		DUR RËS	IS HË M	KAT UN D I RI	MA MI NA S	MA NËZ	RR AS HB UL L	SHI JA K	SUK TH	XH AF ZO TAJ	KA VA JË	LE KA J	SH KO DË R	TIR ANË	VO RË
DUR RËS	100,0 0%	92,44 %		0,10 %	0,09 %	0,09 %	0,3 3%		0,04 %	0,94 %	0,4 2%	2,20 %	0,02 %	3,27 %	0,05 %
ISHË M	100,0 0%	13,36 %	83, 19 %							1,72 %				1,72 %	
KAT UND I RI	100,0 0%	32,05 %		38,34 %	0,57 %		1,7 2%			21,0 3%		3,86 %	1,14 %	1,29 %	
MAN ËZ	100,0 0%	11,82 %			2,63 %	68,93 %		5,69 %	3,50 %	7,44 %					
RRAS HBUL L	100,0 0%	72,81 %		0,24 %			4,2 2%		0,30 %	14,6 3%	1,2 5%	1,13 %		5,12 %	0,30 %
SUKT H	100,0 0%	11,83 %				0,48 %	0,5 5%		36,09 %	47,6 4%		3,14 %		0,27 %	

Nga sa me sipër dhe nga të dhënat shtese që pasojne mund të konkludohet se levizjet e banoreve mes NJA-ve të Bashkisë Durrës kryhen kryesisht drejt NJA Durrës, dhe aspak mes tyre³.

Nga të dhënat rezulton që 40 – 60% e të punësuarve të Manzës punojnë në zonat ku banojnë, ndërsa pjesa tjetër udhëtojnë për të punuar në zonat fqinje, respektivisht drejt Durrësit, Shijakut dhe Xhafzotaj. Niveli më i ulët i punësimit në zonën e banimit dhe tendenca më e lartë për të punuar në NJA-të kufitare vihet re në Katundin e Ri, Sukth, e Rrashbull i cili është edhe tregues i zhvillimit të ulët ekonomik të këtyre NJA-ve.

³Te dhënat e paraqitura ne kete seksion jane marre nga Programi i Zonws Funksionale, Bashkia e Re Durrws.

Ne Bashkinë Durrës mundësia për të patur një zhvillim rajonal të qëndrueshëm realizohet në një nderthurje të dimensionit administrativ në përputhje me zhvillimin urban dhe shërbimin ndaj qytetarit, me dinamikën e zhvillimit demografik dhe të biznesit. Në këtë kontekst janë identifikuar tre tendenca afatgjata të zhvillimit urban në Bashkinë e Durrësi të cilat do të kushtëzojnë shkallën e zhvillimit rajonal si më poshtë:

- i. *Rrashbulli si lagje e Durrësi t.* Zhvillimi aktual i sipërfaqes urbane tregon një bashkim në të ardhmen të Rrashbullit me pjesën jugore të qytetit të Durrësi t. Qyteza e Rrashbullit nuk ka asnjë ndryshim morfologjik me lagjet jugore të qytetit. Ky projektion e vendos këtë qytezë pas 5 – 10 vjetësh si lagje të Durrësi t me të njëjtat procedura dhe funksione. Në këtë këndvështrim duhen riparë dhe kufijte gjeografike pasi pjesa veriore e NjA Rrashbull pothuajse nuk ka aspak lidhje organike me qendrën e njësive administrative. Si e tillë banorët e kësaj pjese mund të marrin shërbimet në lagjet/njësiet që i kanë fizikisht më afër;
- ii. *Qyteti KIS⁴.* Katundi i Ri dhe Sukthi janë morfologjikisht e njëjta zonë urbane, të ndara nga lu Lumin e Erzenit. Të dy njësiet kanë profil ekonomik të orientuar nga bujqësia (me Sukthin më të zhvilluar në drejtim të industrisë së lehtë dhe më pozitive me avantazhuesë ndaj akteve rrugore kombëtare). Lidhja e dy zonave urbane me minimumi tre ura të lehta kembesore dhe të pakten një ure me automjete do të mundësonte: a) lëvizjen me fluide të personave mes dy zonave; b) shkurtime të kostos të lidhjes së Katundi i Ri me autostradën për personat dhe bizneset e Katundit të R ; c) krijonte një bashkësi urbane mes dy zonave duke eliminuar pengesën natyrore të Erzenit. Në afatgjatë, shërbimet administrative mund të ofrohen vetëm në një qendër administrative duke ekonomizuar kostot;
- iii. *Shkafanë – veriu i Manzes* si zonë shërbimesh për verin e Bashkisë. Pjesa veriore e bashkisë është kryesisht NjA e Ishmit. Funksionalisht kjo zonë përbehet nga tre pjesë: a) zona bregdetare që ka njohur një zhvillim të madh 10 vitet e fundit të përktër në zhvillim urban të Shkafanë dhe të plazhit të Gjirit të Lalzit; b) Ishmi si qendër administrative e përbërë nga kater fshatra me rreth 4.000 banorë të orientuar në zhvillimin agroturistik.

V.3. Zhvillimi rajonal sipas sektorëve

Zhvillimi rajonal në Bashkinë Durrës bazohet në tendencat e zhvillimit të fushave si turizëm dhe bujqësi.

Turizmi: Në bazë të vlerësimit të kushteve aktuale për zhvillimin e turizmit në funksion të zhvillimit rajonal mund të përqendrohen në Ishëm (si zona më a pademtuar dhe me potencial më të lartë për shërbime elitare) dhe në agroturizëm brenda gjatë gjithë vitit. Gjithashtu, për turizmin gjatë gjithë vitit ka potencial shumë të lartë Sukthi, Katundi i Ri dhe Manza. Profili i shërbimeve mund të ndërtohet rreth produkteve vendore si vera, djathi (janë identifikuar dy “Rruge Vere” që prekin tre komunat) dhe turizmit fetar (janë identifikuar deri tani pesë fshatra në disa komuna ku bashkejetojnë të pakten dy komunitet fetarë të ndryshëm).

⁴ Bashkimi i emrave të dy NjA-ve Katundi i Ri dhe Sukthi.

Performanca e turizmit e vendos atë në vendin e parë të listës së kontribuesve për zhvillimin e produktit rajonal e ndërthurur kjo me planifikimin e ndërtimit të Portit Turistik dhe rikualifikimin e vijës bregdetare të NJA Durrës dhe hapjen e plazheve të reja në veri të qytetit drejt zonës së Kallmit.

Bujqësia: Ne Bashkinë Durrës ne zhvillimit rajonal , bujqesia parashikohet të jete nje fushë e rendesishem me ndikim në zhvillimin rajona. Kjo, jo vetem per faktin se siperfaqja ne administrim e tokes bujqesore qe perfshin bashkia aktualisht ze afwrsisht 37% te tokes bujqesore te qarkut te Durrësi t, por edhe rreth 42% e popullsise e perqendruar ne fshatra merret me kete aktivitet. Bashkia Durrës ka 19,456 ha tokë bujqësore, ndërsa toka jo bujqesore (fondi pyjor, kullosor, etj.) arrin në 14,239 .

Ne nivel NjA-je, bujqesia është shumë e rëndësishme për Katundin e Ri,Manzën dhe Sukthin. Shumica e fermerëve u shesin produktet e tyre blerësve që udhëtojnë në feramat e tyre nga Tirana ose Durrësit. Tregjet provizore mund të gjenden në Sukth për shitjen e produkteve bujqësore dhe shumica ndodhin gjatë fundjavave. Këto tregje kanë tendencë për t'i shërbyer perkohësisht popullsisë vendase por nuk duket të kenë aftësi për të tërhequr njerëz ose blerës nga rajone të tjera. Një praktikë shtesë konsiston në dërgimin e produkteve në tregun e Shkozetit ose në lehtësirat frigoriferike në Rrashbull. Tregu i Shkozetit përdoret nga fermerët që vijnë nga Manza, Sukthi, Katundi i Ri dhe Rrashbull.

Sfidat me te cilat perballet bujqesia jane informaliteti i larte i sektorit, kostot e larta te inputeve te blera, standardet e sigurise ushqimore, fragmentizimi i tokes, moskoordinimi midis lojtareve ne zhinxhirin e prodhimit/furnizimit.

Më qëllimin që bujqësia të shërbej si një katalizator rajonal, duhet që madhesia e fermes si siperfaqe toke ne dispozicion të rritet. Ne shkalle qarku rezulton se madhesia mesatare e fermes është 1.14 ha. Nga llogaritjet indirekte tw kryera madhesia mesatare e fermes ne Durrës është 1.43 ha, me minimum mesataren e fermes se Ishmit prej 0.91 ha dhe maksimum mesataren e fermes ne Sukth prej 1,61ha. Ndaj arrihet nw konkluzionin se Bashkia Durrës në funksion të zhvillimit rajonal me fokus bujqësinë duhet te kete prioritete te zhvillimit ekonomik krijimin e fermave te medha bujqesore e blektorale ne menyre qe te rritet perdorimi i mekanikes bujqesore e per rrjedhoje te lehtesohet puna e gjalle e fermereve e te sigurohen rendimete me te larta.

V.3 Konkluzion

Bashkia Durrës, është me karakter tw dukshem monocentrik, ku vihet re ekzistenca e një qendre të madhe rajonale me një prurje të fortë të banorëve të rinj. NJA Durrës se bashku me rrethinat është shumë e rëndësishme për te gjithë zonen si qender ekonomike. Por, ndërkohë që qendra rajonale është shumë e fuqishme, ka gjithashtu nën-qendra më të vogla të cilat shërbejnë si një qendër lokale për zonat e tyre rurale përreth. Në një mënyrë ne Bashkinë Durrës gjenden zona me dy lloje qendrash te specializuara: kryeqytetime i madh i rajonit qe ofron kryeqendren ekonomike & sociale dhe qytetet/njësitë administrative te shpendara ne zonë ku njerëzit marrin disa nga shërbimet komunale dhe përdorin tregjet lokale.

Zhvillimi Rajonal i Bashkise Durrës identifikon tre nivele të mbivendosur faktoresh kushtezues të zhvillimit të saj rajonal –territorial si: nderkombetar, kombetar dhe lokal.

Niveli *nderkombetar* ndjek politikat evropiane të konektivitetit sic percaktuar në Axhenden e Berlinit dhe të rrjeteve baze (Core Netëorks). Në këto nivel porti i Durrësi t dhe Hekurudhat Shqiptare pritet të ofrojnë tregun dhe kërkesën për infrastrukturë, shërbime logjistike dhe financiare të nivelit evropian. Financimi i këtyre zhvillimeve do të varet ngapolitikat kombetare dhe lobimi në nivelet evropiane.

Në planin *kombetar* është kryesisht Durana: i.e. nderveprimi i Durrësi t me Tiranën - që do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të korridorit nga Vora në Shkozë. është me interes dhe oferta turistike e Durrësi t përmes turizmit cilesor detar në Kallm dhe në zonën e Ishmit, dhe atij kodrinor ditur në kodrat e Manzes dhe Ishmit adresuar kryesisht banorëve të Tiranës.

Në nivelin *lokal* vihen re tre tendenca të rëndësishme në zhvillimin e territorit bazuar në evolucionin e tre poleve urbane: a) zmadhimin e qytetit të Durrësi t nëpërmjet bashkimit të Rrashbullit; b) krijimin e qytezës KIS përmes bashkimit të Katund i ri – Sukth; dhe c) krijimin e një poli të ri aktiviteti demografik, ekonomik dhe mbështetje logjistike të turizmit plazh dhe kodrinor në zonën e Shkafanës. Këto tre pole zhvillimi do të kushtezojnë intensitetin e flukseve brenda territorit të Durrësi t.

Gjithashtu, politika rajonale dhe kohezionit⁵ në rajonin e Durrësit do të zhvillohen në mbështetje të politikave të BE-së për zhvillimin rajonal. Nisur nga ky fakt orientimi i politikave rajonale në bashkinë Durrës do të ketë komponent kryesor a) investimet për zhvillim ekonomik & social, dhe b) bashkëpunimi territorial midis NJA-ve.

⁵ Politika Rajonale e BE mund të konsultohet në faqen e Internetit - http://europa.eu/pol/reg/index_en.htm

KAPITULLI VI. ZHVILLIMI EKONOMIK

VI.1. Prezantimi i pergjithshem i ekonomise se Bashkisë Durrës

Bashkia Durrës ka një potencial të lartë të zhvillimit ekonomik, pas Tiranës, Durrësi është zona e dytë ekonomike me e rendesishme në vend për nga aktiviteti ekonomik. Sipas të dhënave të Regjistrit të Ndermarrjeve 2014, INSTAT, Qarku i Durrësi të fund të vitit 2014 kishte gjithsej 9,578 subjekte aktive të përdorura në sektorët:

- prodhuesit e shërbimeve: 7,884 subjekte, duke përfaqësuar 82.3%;
- tregti: 3,998 subjekte, ose 41.7%;
- prodhuesit e të mirave: 1,694 subjekte, ose 17.7%.

Faktore të ndryshme si pozicioni i qytetit, prezenca e portit me të madh në vend, të ardhurat financiare të konsiderueshme si dhe asetet natyrore dhe kulturore kanë mbështetur gjatë kësaj kohe zhvillimin e qytetit. Në fund të vitit 2014, në qarkun e Durrësit gjendeshin 27.6% të ndërmarrjeve, ku 8.2% të këtyre ndërmarrjeve kanë administratore femër; përafërsisht 6.9% e ndërmarrjeve bujqesore aktive në Shqipëri janë të përdorura në rajonin e Durrësi të. Përveç kësaj, në këtë qark gjenden 10.23% e ndërmarrjeve industriale, 11% e kompanive të ndërtimit, 9.2% e kompanive të transportit, 8.9% e ndërmarrjeve të tregëtisë, 10% të prodhuesëve të të mirave, dhe 8.2% të prodhuesve të shërbimeveshërbimeve.

Edhe pse me pozitë gjeografike të favorshme dhe me tradita të hershme turistike e tregtare, qarku Durrës ka një nivel varfërie më të lartë se sa mesatarja e vendit. Sipas LSMS-së të vitit 2012, qarku Durrës shënon një nivel varfërie prej 16,2%, me thellësi 3,3% dhe ashpërsi 1,1%, ndërkohë që nivelet mesatare të këtyre treguesve në vend janë 14,3%, 2,9% dhe 1%. Kjo dukuri është pasojë e dallimeve të mëdha në zhvillim midis zonave urbane më të pasura dhe zonave rurale të pazhvilluara.

VI.2. Te dhena sektoret ekonomike ne Bashkinë Durrës

Tabela 2 : Sektoret me te rendesishem ekonomike – Njesi Ekonomike (NjE) / NjA

	Industri Perpunuese			Tregtia shumice / Pakice / Riparim etc			Transporti / Magazinimi			Akomodimi / Sherbimi Ushqimor			Administrimi Publik Mbrotjtja / etc			Mes atarj a te pun esua r / NjE
	nr i NjE	% ref. total NjE	nr te pu nes uar	nr i NjE	% ref. total NjE	nr te pu nes uar	nr i NjE	% ref. total NjE	nr te pun esu ar	nr i NjE	% ref. total NjE	nr te pun esu ar	nr i NjE	% ref. total NjE	nr te pun esu ar	
Durrës	403	9,2	7 6 26	1 70 2	38, 7	5 2 61	372	8,5	3 33 0	543	12, 3	1 48 2	30	0,7	2 04 0	6
Ishem	5	10, 0	20	20	38, 0	33	5	10, 0	5	12	23, 0	13	1	2,0	79	4
KiR	8	12, 7	30	27	42, 9	82	11	17, 5	11	7	11, 1	11	2	3,2	106	5
Manze	11	12, 6	15	36	41, 4	75	11	12, 3	14	9	10, 3	11	1	1,1	48	2
Rrashb ull	41	12, 2	381	148	44, 2	263	25	7,5	42	66	19, 7	155	2	0,6	63	3
Sukth	34	14, 8	226	112	48, 7	287	20	8,7	26	28	12, 2	40	1	0,4	120	4
Total	502		8 2 98	2 04 5		6 0 01	444		3 42 8	665		1 71 2	37		2 45 6	
Mesatar e / sector			16, 53			2,9 3			7,72			2,57			66,3 8	

Burimi: Tatimet, NjQV, Llogaritjet e autoreve

Nga kjo tabelë mund të veme re që Tregëtia me Shumice / Pakice / Riparim etj ka numrin më të madh të NjE por me mesataren më të ulët të të punësuarve për NjE. Nderkohë administrata publike ka numrin më të lartë të të punësuarve për organizatë.

Tabela 3: Ndermarrjet aktive sipas sektoreve në Bashkinë e Durrësit

NJA	Gjithsej	Pasuritë e patundshme dhe dhënie	Agrikulturë	Industri	Ndërtim	Prodhuesit e shërbimeve	Tregti	Transport dhe komunikim	Akomodim dhe ushqim	Shëndet & veprimtarë	Shërbime të tjera
Bashkia Durrës	11685	598	185	1000	655	501	4629	997	1846	187	1087
Manzë	188	8	14	20	8	8	62	21	25	4	18
Sukth	482	0	28	52	18	15	207	51	62	9	40
Ishëm	188	2	8	11	7	9	53	13	67	1	17
Katundi i Ri	149	0	9	15	4	1	45	19	42	1	13
Rrashbull	847	35	8	62	103	19	289	66	189	4	72
Gjithsej	13539	643	252	1160	795	553	5285	1167	2231	206	1247

Burimi: tatimet, NjQV, llogaritjet e autoreve

Sipas tabelës së mësipërme Bashkia Durrës ka 13.539 njësi ekonomike aktive të regjistruara, ndërsa peshën më të madhe të njësive ekonomike të regjistruara e zënë sektorët: tregëti me 5285 biznese, industri 116,0 akomodim; gastronomi me 2231 biznese, etj.

VI.3. Tregtia

Në sektorin e tregëtisë bëjnë pjesë edhe njësitë ekonomike: riparimi i automobilitave dhe artikujt shtëpiakë. Përqëndrimi më i madh i këtyre njësive është në NjA Durrës, Rrashbull dhe Sukth. Ndërsa NjA Manza dhe Ishëm figurojnë me numër të vogël, është NjA Katundi i Ri që mban një peshë relativisht të ulët të këtij sektori, në raport me gjithë Bashkinë Durrës.


VI.4. Akomodimi & shërbimi ushqimor

Në këtë grup bëjnë pjesë edhe njesitë ekonomike që ofrojnë shërbime për turistët vendas dhe të huaj. Numri i madh i këtyre njesive është në Durrës, si dhe në Rrëshbull, në këto të fundit të vendosura ekskluzivisht në zonën bregdetare.

Duhet theksuar që profili i njesive ekonomike turistike në zonën bregdetare në Durrës dhe Rrëshbull janë të orientuara drejt një klientele vendore dhe nga rajoni, kryesisht në sezonin veror (fakt që mund të verifikohet dhe nga numri i ulët i të punësuarve për njësi) dhe me fuqi modeste blerëse). Ndërsa Katundi i Ri, Sukthi dhe Ishëm figurojnë me numër të vogël, është Manza që bie në sy me peshën relativisht të ulët të këtij sektori në të gjithë Bashkinë Durrës.

Grafiku 1, më poshtë tregon se ka një përqëndrim më të madh të bizneseve aktive në NJA Durrës me 87% dhe NJA Rrëshbull me 6%, ky përqëndrim biznesesh në këto NJA vjen për shkak të faktorëve të ndryshëm si pozicioni i qytetit, prezenca e portit me të madh, propozimi për zonën e lirë ekonomike Spitalle, asetet natyrore dhe kulturore kanë mbështetur gjatë kësaj kohe zhvillimin e këtyre bizneseve. Ndërsa vihet re se në NJA –të si Manzë, Ishëm, Sukth, Katundi i Ri numri i bizneseve aktive është i papërfillshëm, çka tregon për një aktivitet minimal biznesi të zhvilluar në këto NJA.

Grafiku nr 1




Sipas grafikut 2, më poshtë, vihet re që 39% e bizneseve të regjistruar aktive në NJA Durrës punojnë në sektorin e *Tregtisë*. Vetëm 16% e këtyre bizneseve janë të përqëndruar në sektorin e *Akomodimit dhe Industrisë*.

Ndërsa në secilin prej sektorëve të tjerë operojnë më pak se 10% e bizneseve të regjistruar.

Në këtë analizë nuk janë marrë parasysh sektorët e administrimit publik, aktivitetet financiare, arsimit privat dhe shërbimet shtëpiake.

Grafiku nr 2



VI.5. Pronësia e ndërmarjeve

Persa i perket pronesise, Qarku i Durrësi t numeron 10.075 subjekte shqiptare, 524 subjekte te perbashketa (te huaj dhe shqiptare) dhe 321 subjekte te huaja. Pas qarkut te Tiranes, Qarku i Durrësi ka dukshem numrin me te larte te perqendrimin te kompanive me pronesi te perbashket. Ne kete pikeveshtrim vihet re dominanca e qarte e bashkepunimeve me kompani italiane dhe kosovare.

Tabela 4: Numri i NjE te regjistruara ne Qarkun Durrës me pronesi te perbashket

Shtetet	Numri i njesive ekonomike
Italia	309
Greqia	30
Turqia	26
Kosova	61
Maqedonia	10
Gjermania	27

Sh B A	8
Mbretëria e Bashkuar	4
Austria	C
Republika Popullore e Kinës	5
Të tjera	43
Gjithsej	524

Duke iu referuar te dhenave te INSTAT sipas tabelës së mëposhtme, vihet re se 89.5 % e ndermarrjeve jane njesi ekonomike te vogla qe punesojne 1-4 persona dhe vetem 1.4 % e njesive ekonomike punesojen mbi 50 persona.

Tabela 5: Numri i ndermarrjeve sipas numrit te te punesuarve ne Qarkun e Duresit

Numri te punesuarve per ndermarje	1-4	5-9	10-49	50+
Numri i ndermarrjeve	9,485	505	461	151

VI.6 Konkluzion

Ne baze te vleresimit te kushteve aktuale te ketij sektori sugjerohet qe zhvillimet strategjike ekonomike te perqendrohen ne:

a) Turizëm: Përqendrimi në NJA Ishem, si zona me a pademtuar dhe me potencial me te larte per sherbime turistike elitare, ofruar gjatë gjithë vitit. Per turizmin gjate gjithë vitit ka potencial shume te larte Sukthi, Katundi i Ri dhe Manza. Profili i sherbimeve mund te ndertohe rreth produkteve vendore si vera, djathi (Janë identifikuar dy “Ruge Vere” qe prekin tre komunat, në të cilat aktualisht janë duke u zhvilluar projekte) dhe turizmit fetar (kemi identifikuar deri tani pese fshatra ne disa komuna ku bashkejetojne te pakten dy komunitet fetare te ndryshme).

Ndërkohë NJA Ishem planifikon te zhvilloje pjesen e territorit ne breg te detit, dhe për zonën e NJA Manez, planifikohet nje zone sherbimesh moderne ne funksion te fshatrave turistike te Ishmit.

b) Zhvillimi bujqesor, “Bujqesi, Pyje, Peshkim”

Zhvillimi bujqesor, “Bujqesi, Pyje, Peshkim”, edhe pse rezulton se vetëm 2% e bizneseve të regjistruar operojnë në këtë sektor, luan nje rol te rendesishem ne ekonomine e bashkisë Durrës per dy arsye kryesore.:

- Se pari nje sasi shume e madhe e banoreve ne pesë NJA (vec NJA Durrësi t) merren me bujqesi edhe pse nuk figurojne si te regjistruar ne QKR.
- Se dyti taksa mbi token bujqesore do te jete nje nga sfidat e bashkise Durrës . Bashkia Durrës ka 19,456 ha tokë bujqësore, ndërsa toka jo bujqesore (fondi pyjor, kullosor e te tjera arrin në 14,239 .

c) Zhvillimi i industrise se manifaktures (përpunuese)

Masa kryesore e NjE perbehet nga ndermarrjet facon, ku vec Durrësi t, dallohen Sukthi dhe Rrashbulli. Ky sektor është dhe punedhenesi me i madh me nje total te vleresuar ne rreth 8,298 persona. Punesimi ne kete sektor luan rolin e valvules se clirimit per presionin social te zones dhe varet ekskluzivisht nga eksporti, kryesisht ne Italin fqinje. Keshtu qe cdo strategji zhvillimi mbeshetur ne kete sektor i kalon kufijte e Bashkisë Durrës, si dhe varet ne menyre te drejtperdrejte nga evolucioni i tregjeve nderkombetare dhe i situates ekonomike te vendit fqinje. Ne rastin konkret e ardhmja e Italise si tregu porosites me i madh do te kushtezoje zhvillimet afatshkurtra ne kete sektor.

d) Sherbimet logjistike/ transport

Bashkia Durrës ka rreth 400 ndermarrje që operojnë në këtë sektor. Duke marre parasysht profilin e aktivitetit dhe numrin mesatar te punonjesve per ndermarrje, egzistencen e portit te Durrësi t, te Hekurudhes dhe volumen e transportit per mallra dhe qytetare, sherbimet e logjistikes dhe te transportit ne nivel kombetar dhe nderkombetar behen faktor zhvillimi strategjik kryesisht per Bashkine Durrës. Njesite e tjera administrative priten te perfitojne kryesisht ne punesim.

KAPITULLI VII. ANALIZA DHE VLERESIMI I PROBLEMATIKAVE SOCIALE

Bashkia Durrës i ofron shërbimet sociale për qytetarët nëpërmjet programit të kujdesit social, i cili parashikon hartimin e programeve lokale të kujdesit social për të gjitha shtresat përmes programeve specifike për 3 kategoritë kryesore: personat me aftësi të kufizuara; fëmijët dhe të rinjtë; moshë e tretë.

Aktualisht, të dhënat e paraqesin Bashkinë e Durrësit me një nivel prej 8947 personash të - papunë, nga të cilët, 548. përfitojnë pagesë papunësie dhe 1442 familje trajtohen me ndihmë ekonomike. Familjet me të ardhura të pamjaftueshme trajtohen nëpërmjet skemës së ndihmës ekonomike si dhe skemave alternative si: Nxitja e punës në komunitet apo kombinimit të ndihmës ekonomike me ofrimin e shërbimeve sociale.

VII.1. Rendi dhe siguria publike

Një problematik tjetër sociale në bashkinë Durrës janë çështjet që lidhen me rendin dhe sigurinë publike. Parimi mbi të cilin orientohet puna e Policisë së Shtetit është “Policimi në Komunitet”, cka do të thotë bashkëpunimi i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës (DPQ) me Bashkinë Durrës/ komunitetin institucionet e arësimit lokal. Duke i'u referuar të dhënave të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës për vitin 2014, evidentohet se problematikat që kërkojnë një vëmendje të veçantë, lidhur me rendin dhe sigurinë në Bashkinë Durrës paraqiten si më poshtë:

- **Krimi i Organizuar.** Sipas analizave të policisë së shtetit, veprat penale të evidentuara në këtë fushë në tre vitet e fundit zënë rreth 4% të të gjitha veprave penale të ndodhura mesatarisht brenda një viti, për Durrësin.
- **Krimi Ekonomik Financiar,** zë rreth 5% të të gjithë veprave penale të ndodhur gjatë 2014.
- **Krimet Kundër Personit** kanë pësuar rënie si në numrin total të tyre me 16 raste me pak se vitin e kaluar, po ashtu edhe në zërat e veçantë të vrasjes.
- **Shkatërrimi i Pronës,** ndonëse për vitet e mëparshme përbënte një nga problematikat e kryesore, aktualisht paraqet një rënie por vazhdon të jetë prezent si tendencë. Kjo kategori përbën rreth 0.6% të të gjitha veprave penale.
- **Veprat penale kundër pronës** zënë pjesën më të madhe të veprave penale në tërësi me 23%, duke vazhduar të jenë problematike.
- **Fenomeni i dhunës në familje** ka pësuar një rritje, qoftë të rasteve të kallzimeve të cilat janë objekt i gjykatës për sigurimin e urdhërave të mbrojtjes, qoftë me rastet e trajtuara si vepra penale parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Kjo tregon nga njëra anë përmasat e medha të këtij fenomeni dhe nga ana tjetër ndergjegjesimin e njerezve për denoncimin e këtij fenomeni.

VII.2. Personat me aftësi të kufizuara, moshë e tretë, dhe të drejtat e fëmijëve

Numri i personave me aftësi të kufizuara të regjistruar në Bashkinë Durrës është 5,187 persona. 41,1% e tyre janë përfitues nga skemat e pagesës të ndihmës sociale. (Nëse i referohemi diagnozave në skemën e pagesës së aftësisë së kufizuar, 21.8% janë të verbër, 10.3% janë para e tetraplegjikë dhe 67.9% janë të lindur me aftësi të kufizuar mendore e fizike, vetëm 19.4% e tyre janë përfitues edhe të pagesës për kujdestarinë).

Shërbimi për moshën e tretë në bashkinë Durrës realizohet nëpërmjet shërbimeve në institucion siç është Qendra Ditore e të Moshuarve, kapaciteti i kësaj qendre është 110 të moshuar. Kjo qendër ofron shërbimi psiko-social, shërbim shëndetësor, vakte ushqimore, qendër informacioni si dhe aktivitete kulturore, psiko-sociale për moshën e tretë. Me reformën e re territoriale del si nevojë rritja e kapaciteteve për qendra të ngjashme që ofrojnë po të njëjta shërbime dhe në 5 NJA të tjera përveçse NJA Durrës.

Politikat sociale, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në bashkinë Durrës realizohen nëpërmjet zyrës për "Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve". Politikat fokusohen kryesisht në: Fëmijë me aftësi të kufizuar, fëmijë të braktisur dhe që punojnë, fëmijë të trafikuar, fëmijë të dhunuar në familje, shkollë dhe komunitet, fëmijë të pa regjistruar nga lindja.

Perspektiva e Bashkisë Durrës në lidhje me çështjet sociale në të ardhmen do të fokusohet kryesisht në përmirësime infrastrukturore sociale si dhe rritjen e mundësisë për rritjen e buxhetit për të gjitha kategoritë e marginalizuara specifike :

- Rritjen me 50% të fondit të posaçëm për familjet në nevojë;
- Ndërtimin e Qendrës publike për trajtimin e fëmijëve autikë dhe për të moshuarit;
- Krijimi i qendrave multifunkionale në njësitë vendore për të moshuarit e vetmuar, gratë e dhunuara, fëmijët në situatë rruge, pakicat etniko-kulturore dhe të gjithë bashkëqytetarët në nevojë;

KAPITULLI VIII. ANALIZA E ZHVILLIMIT SOCIAL, PUNËSIMI, EDUKIMI, SHËNDETËSIA

VIII.1. Punësimi

Bazuar në të dhënat e Drejtorisë Rajonale të Punësimit Durrës (2015), numri total i të papunëve të regjistruar në zyrën rajonale të punësimit deri në dhjetor 2015 është 9,131 persona, ndërsa ofertat e punësimit tëshpallura nga kjo drejtori janë 4,338, ku mbizoterojnë ofertat në sektoret e industrisë përpunuese, shërbimeve, transportit.

Sektoret tradicionale që kanë shpallur me shumë oferta pune janë:

Tabela 6. Vendet e lira të punës të shpalluar dhe të plotësuara

Aktivitetet kryesore	Nr. Vendeve të lira	V. lira të plotësuara
Konfeksione	1211	604
Industria e lekureve dhe kepuceve	1547	883
Ind. Të tjera përpunuese	672	461
Shërbime/hoteleri /tregtia/transporti	908	432
Gjithsej	4338	2380

Burimi: Drejtori Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit; llogaritjet e autoreve

Sic duket dhe nga ofertat e publikuara nga Shërbimi i Punësimit, numri më i madh i vendeve të punës janë në aktivitetet fason, kryesisht konfeksione dhe qepje kepucesh. Por dhe këtu vëhet re që një sasi e madhe e vendeve të ofruara nuk arrihet të plotësohet.

Në arsyet kryesore të përmendura për mos-plotesimin e vendeve vakante janë: a) kriteri i moshës, që e vështirëson ndërmjetësimin për punëkërkuarët e papunë mbi 45 vjeç; b) mungesa e arsimit të përshtatshëm; dhe c) mungesa e njohurive dhe përvojës për një profesion të caktuar.

Në vitin 2014 në Bashkinë Durrës figuronin të punësuar rreth 35,000 persona, 4/5 e të cilëve vetëm në NJA Durrës. Me poshtë rrëdhitej Rrëshbulli me 5,7% dhe në fund Ishmi me 0,6%.

Sic vëhet re dhe në analizën ekonomike shërbimet ofrojnë përqindjen më të madhe të punësimit (NJA Durrës zë 68,46%), gjithashtu, vëhet re që sektori i bujqësisë ofron shumicën e vendeve të

punes per NJA-të Sukth Ishwmi dhe deri ne gjysmen e vendeve te punes, si ne rastin e NJA Manez.

Tabela 7. Shkalla e punesimit sipas degeve te ekonomise dhe NjQV

Treguesi (ne %) / Njesi Vendor	Durrës	KiR	Rrashbull	Sukth	Ishem	Manez
Punesimi sipas degeve te ekonomise: bujqesi	2,5	23,4	20,9	26,3	31,6	53,5
Punesimi sipas degeve te ekonomise: industri	29	24,8	35	26,8	17,1	16
Punesimi sipas degeve te ekonomise: sherbime	68,46	51,85	44,11	46,84	51,3	30,51
Statusi i punesimit: te vetepunesuar dhe kontribues familjare	26,7	52,2	38,4	49	56	65

Burimi: Instat, Llogaritjet e autoreve

Persa i perket sektorit publik, sipas të dhënave tw qershorit 2015 (duke llogaritur vetem administraten dhe pa perfshire ndermarrjet shteterore publike), figuronin rreth 6,100 persona, ose 20% e te gjithë të punesuarve. Tabela e meposhteme jep nje veshtrim te permblledhur te shperndarjes se punonjesve te administartes ne secilen nga njesite.

Tabela 8. Shperndarja e punonjesve te administrates per Njesi Administrative

Kategoria / NjA	Bashkia Durrës	Ishem	KiR	Manez	Rrashbull	Sukth	Total
Administrata Publike (Shërbime administrative dhe mbështetëse / Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm / Arsimi / Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale)	5 575	118	137	77	100	157	6 164
Ne % te totalit te Bashkisë Durrës	90,44 %	1,91%	2,22%	1,25%	1,62%	2,55%	100,00 %

Burimi. Tatimet, NjQV dhe llogaritjet e autoreve

Si perfundim, pwrvec “sherbimeve” ku pwrfsihet dhe adminstrata, ne BashkinëDurrës bujqesia ofron shumicen e vendeve te punws, si nw Sukth (26,3%), Ishwm (31,6%), Katund i Ri (23,4% ose 0,6% me pak se industria) dhe Manez (53,5%). Dhe pse ne vlere absolute keto shifra mund te mos kene rendesi, aktiviteti i bujqesise mbetet jetesor per punesimin si dhe per ekonomine familjare te këtyre zonave, kryesisht sic verehet tek shifrat e te vetepunesuarve dhe te kontribuesve familjare. Cdo politike ekonomike pwr Bashkinë Durrës duhet tw mbaj parasysh kwtw pwrqasje.

VIII.2. Edukimi

Shkalla e nivelit arsimor ne NjA të Bashkisë Durrës është mjaft domethenese. Edhe pse Bashkia Durrës ka perqindjen me te ulet te nivelit arsimor te perfundura per nivelin fillor dhe 8 (ose 9) vjecar me 42,45%, ajo ka ndjeshem nivelin mw tw lartw per arsimin e mesem - 38,8%. Per nivelin universitar dhe pasuniversitar NjA e Durrësi t paraqet shifra pese here me te larta se NjA e tjera te kësaj bashkie. Mund te mendohet qe anomalia e nivelit fillor, ndikohet nga popullatat e varfra te zones se kenetes pjesë e NjA Durës.

Tabela 9: Niveli i arsimimit perNJQV

Treguesi (ne %) / Njesia Vendore	Durrës	KiR	Rrashbul l	Sukth	Ishem	Manez
Niveli Arsimor i perfunduar: Fillor dhe 8 ose 9 vjeçar	42,45	69,82	64,63	71,32	72,09	67,48
Niveli Arsimor i perfunduar: i mesem	38,8	22,5	26,7	21,3	18,2	23,7
Niveli Arsimor i perfunduar: universitar dhe pasuniversitar	15,4	3,2	5,3	3	3,3	4
Shkalla e analfabetizmit	1,8	2,8	2,2	2,5	4,6	3,3

Burimi: Instat, Llogaritjet e autoreve

Aktualisht në Bashkinë Durrës ndjekin arsimi bazë 22,663 nxënës, arësimin e mesëm 7,415, në këtë bashki shpërndarja e institucioneve të arësimit sipas secilës NjA dhe numri i nxënësve për secilin institucion paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 10. Institucionet e edukimit ne Bashkinë Durrës:

Institucionet e arsimit	Durrës	KiR	Rrashbul l	Sukth	Ishem	Manez
Universitet publik / privat	(1)					
Shkolla të mesme publike / nr. nxwnwsish	8/ (6,823)	1/262	1/194		1/136	

Shkolla të mesme jo publike / nr. nxwnwsish	7 / (1.161)					
Shkolla të mesme profesionale / nr. nxwnwsish	1/ (678)					
Shkolla 9-vjecare publike / nr. nxwnwsish	22 / (17.000)	9/151 7	7/2669		5/678	5/799
Shkolla 9-vjecare jo publike / nr. nxwnwsish	9/(1.500)					
Kopshte publike / jo publike / nr nxenwsish	28- kopshte (2,300 femije)					
Gjithësej nr shkollash / nr nxenwsish						

Burimi: Drejtoria Rajonale Arsimore Durrës , Llogaritjet e autorëve

Nw lidhje me facilitetet e arsimit ne Durrws nuk mbulohen nevojat ekzistuese, kjo konfirmohet nga informacioni mbi sipërfaqen pwr nxwnws, qw wshtw 6 m² per student/nxenes.Ne ditet e sotme nevoja per sipërfaqe totale per shkolla 9-vjecare është 68,019 m².

Persa i perket ndikimit te arsimit ne punesim, duhet theksuar se ndersa ne NJA Durrës shifra arrin ne 45,4% per nivelin e mesem profesional, ajo zbret ne me pak se nje te treten ne NJA-të e tjera më pak te urbanizuara dhe me mw pak industri & sherbime. Ndërkohë shkalla e punesimit per nivelin arsimor fillor dhe 8 (ose 9) vjecar është ne perpjestim te zhdrejte me shkallen e industrializimit dhe te koncentrimit te ndermarrjeve per NjA.

Tabela 11: Punesimi sipas nivelit arsimor

Treguesi (ne %) / Njesi Vendor	Durrës	KiR	Rrashbul	Sukth	Ishem	Manez
Punesimi sipas nivelit arsimor: fillor dhe 8/9 vjeçar	27,49	60,68	55,17	62,63	53,02	60,13
Punesimi sipas nivelit arsimor: te mesem dhe profesional	45,4	31,98	34,79	29,78	31,43	31,64
Punesimi sipas nivelit arsimor: universitar	26,6	6,2	9,7	6,4	14,5	7,8

Burimi: Instat, Llogaritjet e autoreve

Bazuar në informacionin e Bashkisë Durrës, arsimi profesional është një nga drejtmet

kryesore të politikave vendore për të ardhmen. Në këtë drejtim bashkia do të fokusohet në ofrimin e mundësive për arësim dhe formim profesional cilësor për të rinjtë , nëpërmjet formimin profesional per 300 te rinj per sektorin e turizmit, 200 të rinj në drejtim peshkimit si dhe 200 të reja në drejtim vreshtarinë dhe kulinarinë.

VIII.3. Shëndeti

Sipas ligjit/praktikes se tanishme sistemi shendetsor në Bashkinë Durrës organizohet në:

- Spitale Rajonale (sherbimi ndaj pacientit per rajonin);
- Spitalet Bashkiake (sherbimi ndaj pacientit per bashki);
- Qendrat e Kujdesit Shendetsor (HCC), (sherbim i specializuar per paciente te jashtem per cdo rajon bashkiak);
- Qendrat e Kujdesit Shendetsor Primar te quajtura gjithashtu edhe *ambulanca* (ndihma e pare per paciente te jashtem ku punojne mjeke te pergjithshem).

Ne Bashkine Durrës ka vetem nje spital rajonal (170 shtreter) me një sipërfaqe 27,464 m2, dhe 58 qendra shëndetësore kryesisht ne qender dhe ne pjesen lindore te NJA Durrës.

Tabela e meposhtme tregon informacione te ndryshme mbi facilitetet e shendetit ne Durrës në bazë të numrit të popullësisë si dhe hendekun për plotësimin e tyre, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/ mjeku më i afërt në zonat urbane është 13 minuta

Njesia Vendore	Qendra Shendetesore dhe ambulanca (numer)
3	17
Durrës	12
Manëz	9
Ishëm	12
Katund i Ri	9
Sukth	7
Rashbull	9

Burimi: Drejtoria e shëndetit rajonal Durrës, Llogaritjet e autoreve

KAPITULLI IX. DEMOGRAFIA

Bashkia e Durrësi teshte një prej bashkive me të mëdha të vendit me sipërfaqe prej rreth 298.3 km², struktura e popullsisë e kësaj njësie vendore është 85% urban and 15 rural. Sipas Census-it të popullsisë dhe banesave të vitit 2011 popullsia totale e Bashkisë Durrës 175,110 banorë dhe 45,650 familje. Perberja gjinore është pothuajse e barabarte 87,613 meshkuj dhe 87,497 femra. Popullsia aktive në intervalin 15-64 vjeç përben rreth 68.22 % të numrit të përgjithshëm të banorëve.

Sipas këtyre të dhënave për nga numri i popullsisë, Bashkia Durrës është si dhe Bashkia Tiranë një nga destinacionet kryesore për migrimin e brendshëm.

Popullsia e Qarkut Durrës përbën rreth 9,4% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011, dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 16,424 banorë/NJQV⁶. Kjo mesatare është gati dy herë më e lartë se mesatarja e popullsisë për NJQV në rang vendi (8,016 banorë/NJQV).

Two dhënat e Censusit 2011 janë shumë më të ulëta se ato të Regjistrit të Gjendjes Civile (RGJC). Sipas (RGJC) në dhjetor 2015 popullsia e bashkisë Durrës rezulton se ka 307,743 banorë dhe 91,496 familje. Diferenca e madhe midis popullsisë rezidente dhe asaj në (RGJC) vjen si rrjedhim i emigracionit të lartë që vjen kryesisht nga qyteti i Durrësit dhe zonat përreth. Ky faktor, pasqyrohet në frekuencën shumë të lartë të përfaqësimit të ndermarrjeve të përbashkëta shqiptare - të huaja të vendosura kryesisht në qytetin e Durrësit.

Gjithashtu, Census-i i popullsisë së vitit 2011 evidenton një rritje popullore prej 9% në këtë qark, kryesisht në zonat urbane. Popullsia në zonat urbane të qarkut (bashkitë) u rrit me 56% gjatë kësaj periudhe. Prurjet më të mëdha besohet të kenë ardhur nga zonat rurale të vetë qarkut të cilat janë tkurrur me 46%, si dhe nga zonat verilindore kryesisht të ardhurit në zonën e Kenetes, Bashkia Durrës.

⁶ Njësi të Qeverisjes Vendore

Tabela nr 12. nr i popullësisë dhe familjeve në bashkinë Durrës :

Njësité administrative	Popullësia sipas RGJC	Numër familjesh sipas RGJC	Popullësia sipas Censurit 2011	Numër familjesh sipas Censurit 2011
Bashkia Durrës	213,854	66,765	113,249	30,899
Manzë	11,715	3,014	6,652	1,619
Sukth	27,584	7,243	15,966	3,851
Ishëm	8,945	2,345	5,001	1,273
Katundi i Ri	15,810	4,282	10,161	2,334
Rrashbull	29,835	7,847	24,081	5,674
Gjithsej	307,743	91,496	175,110	45,650

Tabela 13 : Popullsia në bashkinë Durrës sipas ndarjes gjinore

NJA	Numri i banoreve											
	Gjithsej				Meshkuj				Femra			
	Gjiths ej	0-14	15-64	65+	Gjiths ej	0-14	15-64	65+	Gjiths ej	0-14	15-64	65+
Durrës	113,249	21,799	78,528	12,922	56,511	11,467	38,817	6,227	56,738	10,332	39,711	6,695
Sukth	15,966	4,058	10,502	1,379	7,999	2,136	5,178	685	7,967	1,949	5,324	694
Ishëm	5,001	1,174	3,229	598	2,487	596	1,598	293	2,514	578	1,631	305
Katund i ri	10,161	2,453	6,715	993	5,071	1,273	3,332	466	5,090	1,180	3,383	527
Rrashbull	24,081	5,700	16,092	2,289	12,194	3,022	8,045	1,127	11,887	2,678	8,047	1,162
Manëz	6,652	1,502	4,400	750	3,351	778	2,204	369	3,301	724	2,196	381
Gjithsej	175,110	36,686	119,466	18,931	87,613	19,272	59,174	9,167	87,497	17,441	60,292	9,764

Burimi: INSTAT, Census 2011, Llogaritja e autoreve

Bashkia Durrës, është një zone me një dendësi shumë të lartë popullore 681 banorë/km². Ajo është dy herë më e lartë krahasuar me dendësinë në nivel kombëtar (343 banorë/km²). Edhe pse qyteti Durrësit zë vetëm rreth 11.24% të sipërfaqes totale të bashkisë Durrës ajo përfaqëson

rreth 64.67% te popullsisë së bashkisë Durrës duke patur një dendësi dukshëm të lartë. Ndërsa NJA Ishëm mbulon rreth 26.9% të territorit, por ka një dendësi prej vetëm 55 banorë/km².

Tabela 14: Dendësia e popullsisë dhe distanca e NJA-ve në Bashkinë Durrës

NJA	Popullsia	Sip. Km ²	Dendësia banorë/km ²	Distanca nga qendra e bashkisë Durrës
Durrës	113,249	38.00	2,980.00	0.00
Sukth	15,966	53.00	301.00	14.00
Ishëm	5,001	91.00	55.00	37.00
Katund i ri	10,161	54.00	188.00	19.00
Rrashbull	24,081	59.00	408.00	10.00
Manëz	6,652	43.25	154.00	15.00
Gjithsej	175,110	338.25	681.00	

Burimi: INSTAT, Census 201, Llogaritjet e autorëve

Bazuar në analizën e mësipërme vëhet re që Bashkia Durrës është me karakter të dukshëm monocentrik, këtu vëhet re ekzistenca e një qendre të madhe rajonale NJA Durrës dhe Rrashbull, me një prurje të fortë të banorëve të rinj. Qyteti i Durrësit së bashku me rrethinat është shumë i rëndësishëm për të gjithë zonën si qendër ekonomike. Por, ndërkohë që qendra rajonale është shumë e fuqishme, ka gjithashtu nën-qendra më të vogla të cilat shërbejnë si një qendër lokale për zonat e tyre rurale përreth.

KAPITULLI X. STREHIMI

Ekonomia shqiptare ka pesuar ndryshime te rendesishme gjate periudhese tranzicionit si ne drejtim te rritjes se aktivitetit, ashtu edhe ne aspektin institucional dhe rregullativ. Ne vecanti, sektori i ndertimit dhe tregu i banesave kanë perjetuar ndryshime te rendesishme, si dhe kanë dhene kontributin kryesor ne rritjen ekonomike.

Te dhenapër Bashkinë Durrës specifikisht NJA Durrës dhe NJA Rrashbulltregojne se cmimet ⁷e banesave si dhe shitjet e tyre kanë shfaqur rritje te ndjeshme gjate periudhes 2000-2007. Gjate kesaj periudhe, cmimet e banesave jane rritur mesatarisht me rreth 15% ne vit. Ndërsa, zhvillimet gjate periudhes 2008-2013, tregojne per nje ngerc ne tregun e pasurive te paluajtshme, ku cmimet dhe shitjet e banesave kanë shfaqur edhe tkurrje te herepashershme.

Ne Bashkinë Durrës, nder faktoret e pare qe kanë sjellerritje te kerkeses per ndertime te reja, qe prej fillimit te viteve '90, kanë qenemungesa e hapesirave te mjaftueshme per strehim, cilesia e dobet e banesave ekzistuese, ndryshimi i sjelljes se individeve per te jetuar ne familje me te vogla, si dhe ndryshimi i hartes demografike e nxitur nga faktore ekonomike dhe sociale.

Nje burim tjeter kryesor i kerkeses per blerje te apartamenteve te reja në këtë bashki ishte edhe kerkesa nga emigrantet, e cila ka ardhur ne rritje deri ne fund te vitit 2007. Ndërkohë, me fillimin e krizes, kerkesa nga emigrantet për të patur banesa (kryesisht të dyta) në NJA Durrës dhe NJA Rrashbull ka pesuar renie, ne pergjigje te perkeqesimit te kushteve te tregutte punes ne vendet ku jetojne.

Bazuar në të dhëna për NJA Durrës, rezulton se strehim i ri qe kërkohet, vlerësohet te jete rreth 20.000 njësi⁸, duke mundur të ndërtohet vetëm në disa pjesë që nuk përbëjnë berthamen tradicionale të qytetit.

X.1. Stoku i Strehimit

Zhvillimi spekulativ i tregut të banesave i viteve të fundit është shënuar nga një ulje e standardeve për infrastrukturën sociale. Interesat private (mbulimi maksimal i ngastrave dhe densiteti maksimal i ndërtimit) cënon rëndë e ndjeshëm përdorimin e tokës duke zënë pjesën më të madhe të tokës në dispozicion.

Analiza për përballueshmërinë dhe *analiza ekonomike sociale* ⁹në qytetin e Durrësit, ka zbuluar se të varfërit, dhe shumë të varfërit janë aktualisht të përjashtuar nga tregut i strehimit, (pa përfshirë banesat sociale). Gjithashtu vihet re që, mungesa e përballueshmërisë së strehimit mund të ketë implikime në tregun e punës, për punën e pagave të ulëta dhe të rrisë kërkesat në sistemet e transportit (sepse punëtorët udhëtojnë në

⁷ Banka e Shqiperise, Zhvillimet ne tregun e banesave

⁸ IPV Durrës 2013 – kapitulli strehimi

⁹ Buletini statistikor 2014 – Bashkia Durrës

distanca ndërmjet punës dhe strehimit të përballueshëm).

Stoku¹⁰ i Strehimit të Durrësit përbëhet nga:

- Blloqe apartamentesh (4-5 kate) të ndërtuara në periudhën socialiste (rreth 1970) ku akomodohet përafërsisht 40% e popullsisë (80% e popullsisë në vitin 1990). Këto ndërtesa janë të kualitetit të mesëm etë ulët, por banorët i kanë përmirësuar me kalimin e kohës, të gjitha këto shtëpi janë të lidhura me shërbimet publike. Të njëjtën specifik ndërtimi e gjejmë në NJA-të Sukth dhe Manz.
- Shtëpitë tradicionale të vecuara, në NJA Durrës jetojnë rreth 13,5% e popullsisë dhe të gjitha këto shtëpi janë të lidhura me shërbimet publike, ndërsa në NJA-të Ishëm, Katundi i Ri, Rrashbull jeton një përqindje jo shumë e madhe e popullsisë së këtyre NJA-ve, pasi pas viteve 1990 pjesa dërmuese e popullsisë ka ndërtuar apo ka rikonstruktuar banesat tradicionale.
- Shtëpitë e ndërtuara rishtaz 1-3 kate, në NJA Durrës jeton rreth 45% të popullsisë. Ndërsa rreth 95% e popullatës së 5 NJA-te e tjera të Bashkisë Durrës jetojnë rreth 95% e popullatës së tyre në këto shtëpi (duhet të theksohet se këto shtëpi nuk kanë lidhje të mirë me shërbimet publike, si infrastrukturë rrugore, ujësjellës apo kanalizim me përjashtim të lidhjes me energjinë elektrike.
- Ndertesa te reja shumë-katëshe (5 deri 8 kate) ku jeton rreth 1,5% e popullsisë në NJA Durrës.
- Ndertesa te reja shumë-katëshe (8-15 kate) (këto përdoren kryesisht përkohësisht në verë) me rreth 15,000 njësi në zonën e plazhit, pjesërisht NJA Durrës dhe NJA Rrashbull. Këto objekte janë të natyrës spekulative dhe të standardeve shumë të ulët të ndërtimit.

X.2. Banesat Sociale

Strehimi social në Shqipëri është një politik që zbatohet në nivel lokal nga NJQV dhe në nivel kombëtar nga Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU). Politika e strhimit social në Bashkinë Durrës mbulohet nga një program i vecantë buxhetor. Ky program mbështet kategori të caktuara të qytetarëve në nevojë të evidentuara të klasifikuara sipas disa kriterëve të përcaktuar me akte ligjore e nen ligjore.

Në bashkinë Durrës, gjatë viteve 2009-2013 për zbutjen e problemit të strehimit të shtresave të varfra është realizuar një projekt për ndërtimin e 342 apartamenteve sociale me qira me kosto të ulët. Ky projekt mundësojë zbutjen e problemit të strehimit tek shtresat e varfra të shoqërisë në qytetin e Durrësi t.

Nga politikat për strhimin në bashkinë Durrës deri në dhjetor 2015 kanë përfituar 126 familje, ndërkohë që janë 216 banesa sociale janë duke u ndërtuar, 88 prej tyre janë duke u ndërtuar në zonën e Shkozetit.

¹⁰ Këto të dhëna janë përcaktuar nga plani i përgjithshëm vendor Bashkia Durrës nëpërmjet një studimi të tokave duke përdorur një analizë të orthophotos së qytetit, në mungesë të të dhënave të besueshme statistikore.

Gjithashtu, janë trajtuar me kredi të zubutur nga 0-3%, 306 familje gjatë viteve 2011-2015, prej të cilave, 98 familje përfituan kredi me 0% interes, 148 familje përfituan kredi me 3% interes, 60 familje përfitojnë nga fondi i posaçëm nga këto 33 gra kryefamiljare.

KAPITULLI XI. INFRASTRUKTURA

Ne kete kapitull do te trajtojme rruget & transportin publik, purnizimin me energji, telekomunikacioni, menaxhimi imbeturinae, ujësjells/kanalizimet, hapësirat publike dhe të gjelbërta.

XI.1. Infrastruktura rrugore & Transporti Publik

Bashkia Durrës është e lidhur me akset kryesore rrugore, ajo është hyrja e Korridorit të VIII panevropian që perfundon në Varna të Bullgarisë. Durrësi është një rrugore që lidh veriun me jugun e Shqipërisë.

Durrësi ndodhet rreth 35 Km larg Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë. Durrësi ndodhet në fund të aksit metropolitan perëndimor Tiranë-Durrës, dhe lidhet me kryeqytetin nga një autostradë. Ai është gjithashtu lehtësisht i arritshëm nga qytetet të tjera të vendit me anë të një sistemi të mirë të transportit rrugor.

Tabela 15. Rrjeti rrugor i Bashkisë Durrës

Njësia Administrative	Gjatësia në km
Durrës	100
Ishëm	52
Rrashbull	23
Sukth	16
Katundi i Ri	15
Manez	19
Total	225 km

burimi: dldp, llogaritjet e autoreve

Nga informacioni i mësipërm rezulton se, në total bashkia Durrës ka të asfaltuara 225 km rrugë, pavarësisht investimeve të kryera në infrastrukturën rrugore situata urbane në Bashkinë Durrës paraqitet relativisht positive, kjo për shkak të mungesës së një sistemi hierarkik rrugësh të përshtatshëm dhe planeve të integruara rrugore, të cilat krijojnë vështirësi në trafik gjatë gjithë ditës, duke reduktuar (dhe shtuar) lëvizjen urbane. Gjithashtu, mungesa e rrugëve dytësore, gjeneron trafik të rënduar duke përzier transportin publik dhe atë qytetar.

Ndër problemet kryesore të evidentuara në lidhje me infrastrukturën rrugore përmendim a) Nyjet e trafikut dhe problemet e parkimit; b) transportit publik nuk mbulon të gjithë Bashkinë

Durrës; c) mungesa e sigurisë për këmbësorët dhe çiklistët; d) impakti negativ ekologjik nga rritja e trafikut rrugor; e) mungesa e një rrjeti të brendshëm rrugor, i cili të lidhë NJA-te me njëra tjetrën duke shmangur kalimi në autostradë.

Transporti Publik: Rajoni i Durrësit është një ndër rajonet që nderthuret më mire me rrjetin rrugor krahasuar me rajonet e tjerat të Shqipërisë. NJADurrës lidhet direkt me NJA Rrashbull, NJA Sukth dhe NJA Katundi i Ri.

Tabela 16. Itineraret e transportit në Bashkinë Durrës

	Manez	Ishem	Sukth	Shijak	Katund i Ri	Durrës
Manez		Daily MB	Daily MB	Daily MB	Daily Via Sukth	Daily MB
Ishem	Daily MB		Daily MB	Daily MB	Daily Via Sukth	Daily MB
Sukth	Daily MB	Daily MB		Daily MB	Daily Bus	Daily Bus/M B
Shijak	Daily MB	Daily MB	Daily MB		Daily Via Durrës	Daily Bus/M B
Katund i Ri	Daily Via Sukth	Daily Via Sukth	Daily Bus	Daily Via Durrës		Daily Bus
Durrës	Daily MB	Daily MB	Daily Bus/MB	Daily Bus/MB	Daily Bus	

Burimi: dldp, llogaritjet e autoreve

XI.2. Furnizimi me energji ¹¹

Gjendja e tanishme dhe niveli i shërbimeve të sistemit elektrik është rinovuar gjatë viteve në pjesën qendrore të NJA Durrës. Rrjeti i tensionit të mesëm është ngritur në 20 KV. Kabllot janë shtruar nën tokë siç duhet dhe kapaciteti i transformatorëve është i mjaftueshëm. Numri i klientëve (61,725) që përfshin edhe NJA-të e tjera të Bashkisë Durrës tregon që norma e lidhjes është 100%.

Në zonat informale është i nevojshëm rinovimi i sistemit ekzistues të improvizuar. Tensioni i mesëm në këto zona është akoma 6 KV, me humbje të mëdha në linjat ajrore. Kapaciteti i nënstacioneve prej 157 MW është i mjaftueshëm, por do të zgjerohet me 20% deri në vitin 2020. Problemi kryesor i tanishëm janë ndërprerjet e energjisë së shkaktuara nga pamjaftueshmëria e furnizimit.

XI.3. Telekomunikacioni ¹²

Gjendja e tanishme dhe niveli i shërbimeve të telefonisë në bashkinë Durrës numëron 20,290 klientë të regjistruar, që është e barabartë me 42% të familjeve që janë të lidhura me sistemin telefonik.

Kapaciteti i lirë i paneleve është 5,000 njësi lidhje. Kështu që edhe 10% e familjeve mund të lidhen. Sidoqoftë, në zonat informale, rrjeti mungon. Gjithashtu rreth 60% e rrjetit është akoma me linjë ajrore. Rrjeti interurban me fibër optike prej 47 km është i mjaftueshëm për të ardhmen e afërt. Telefoni celular është i ofruar në të gjithë Bashkinë Durrës nga kompani të ndryshme.

XI.4. Menaxhimi i Mbeturinave

Mesatarisht, një familje në qytetin e Durrësit prodhon rreth 2 ton mbetje në vit ose 5.5 kg mbetje në ditë (sipas llogaritjeve të bazuara në të dhënat e marra nga Bashkia e Durrësit). Sasia e mbeturinave të ngurta në Durrës është rreth 450 kg/v/c shumë e ngjashme me mesataren evropiane.

Në Bashkinë Durrës nuk ka grumbullim të diferencuar të mbeturinave për mbeturinat e zakonshme dhe të ndërtimit. Gjithashtu, nuk është vendosur asnjë kufizim kohor për depozitimin e mbeturinave nga banorët. Pasi kryhet mbledhja e mbeturinave, hidhen në vend depozitimet ekzistuese në zonën e Kënetës dhe digjen pa masa paraprake. Kjo është një procedure e dëmshme për shkak të emetimit të gazit helmues si dhe përbën rrezikshmëri të lartë për ndotjen e ujërave nëntokësore.

Një proces i ri ka filluar përndertimin e landfillit të ri sanitar në një sipëfaqe prej 15 Ha. Ky shërbim do të mbulojë të gjithë territorin e Bashkisë Durrës dhe do të krijojë mundësinë e hapjes së 1500 vendeve të reja të punës kostoja e tij është parashikuar 6.5 milion euro.

¹¹ Percaktuar vetëm për NJA Durrës, mungon informacionin për gjithë territorin e bashkisë

¹² IPV Durrës (Percaktuar vetëm për NJA Durrës, mungon informacionin për gjithë territorin e bashkisë)

XI.5. Furnizimi me Ujë

Furnizimi me ujë dhe kanalizime për Bashkinë e Durrësit, mundësohet nga Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Durrës (ShUKD). Sasia ditore e furnizimit për të gjithë sistemin është 74,000 m³. ShUKD administron dy sisteme të pavarura furnizimi me ujë nga pellgjet ujëmbajtës në Fushë-Kuqe dhe në Fushë-Krujë:

- Prodhimi bëhet në Fushe Kuqe (14,000 m³/dite ekuivalent i 18%) dhe Fushe Krujë (59,963 m³ /dite ekuivalent i 81%). Një pjesë shumë e vogël - rreth 1% - blihet nga Kavaja);

Popullsia e Bashkisë Durrës, që furnizohet me ujë është rreth 80 %, ndërsa kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë në ditë 6 ore. Për më tepër 20% të fshatrave/lagjeve nuk kanë një sistem furnizimi me ujë .

XI.6. Sistemi i kanalizimeve

Sistemi ujërave të zeza të NJA Durrës (system i vecantë) ishte ndërtuar para viteve 1990 për një popullsi prej 90,000 personash. Në atë kohë lidhja me shërbimin ishte 100%. Gjatë viteve 1993 deri 2007 janë bërë investime shumë të kufizuara në sistemin e kanalizimeve, pjesa e familjeve të lidhura me rrjetet e ujë të zeza është mesatarisht 55% në qytet. Zona rurale nuk kanë rrjet kanalizimi. Menyra kryesore e depozitimit të ujërave të zeza, sidomos në zonat informale si dhe në 5 NJA janë gropat septike, mbimbushja e të cilave shkon në kanalet kulluese bujqesore me kapacitet të pamjaftueshëm.

Gjatesia e tubave kryesore, rezervuareve, impianteve të trajtimit, është rreth 165 km. Ndërsa gjatesia e rrjetit sekondar të tubacionit, numri i lidhjeve me shtepite është rreth 472 km.

XI.7. Hapësirat publike dhe të gjelbërta

Hapësirat publike dhe të gjelbërta përmblendhin rrugët me gjelberim, lulishtet të lagjeve, parqet urbane. Sipas normave të tanishme kombëtare standarti i referuar është 7 m² për person, i cili përputhet pothuajse plotësisht me praktiken e vendeve BE.

Në NJA Durrës sipërfaqja ekzistuese e gjelber kufizohet me spote shumë të vogla në qendër të qytetit përveç zonës së gjelber përgjatë frontit detar në perëndim të portit, dhe tek kodra e "Vile Mbreterore".

Ndërsa për NJA-të e tjera hapësirat publike të organizuara pothuajse mungojnë. Hapësirat e gjelbërta në Durrës janë në nivel të kënaqshëm për popullatën. Mesatarja për person është rreth 6.7 m². Një park i ri është planifikuar në fushën e Kallmit, në veri të Durrësit, që do të bëjë të mundur rritjen e zonës së gjelbër në Durrës, përmes ndërhyrjeve do të përmirësohet rinatyalizimi i Kodër Vile me vlerë 150 000 euro dhe mbjellsjes së 6000 pemëve të reja me qëllim rritjen e treguesëve të sipërfaqes së gjelber për banor nga 6.7 m² në 8 m² dhe eliminimin e ndotjes së ajrit.

Kjo zonë, së bashku me zonat e tjera të afërta do të krijojë Parkun Metropolitan të qytetit.

Plani Pergjithshëm Vendor i cili do të pasoj këtë strategji Zhvillimi do të orientojë mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të hapësirave publike dhe të hapura në bashkinë Durrës përmes procesit të planifikimit të detajuar të zonave informale të cilat do të mundësojnë përcaktimin e hapësirave të reja të hapura.

XI.8. Planet strategjike për sektorët e infrastrukturës

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet: Objektivi është reduktimi i Ujit Pa të Ardhura (humbjeve të ujit) si përqindje e volumit të ujit të prodhuar, nga 71.4% në vitin 2013, në 50% në vitin 2018. Projekti më i rëndësishëm është projekti i Bankes Botërore për US\$ 85 milion, i cili do të fokusohet si më poshte:

- Komponenti 1: Rrjeti i Furnizimit me Ujë fokusuar në krijimin e Kapaciteteve të reja prodhuese por dhe në Rehabilitim rrjeti shpërndarjes. Investime Prioritare janë për Furnizimin me Ujë, ku futet financimi i linjës së re të furnizimit përfshirë një stacion të ri pompimi në Fushëkuqe.
- Komponenti 2: Rrjeti i Largim / Grumbullimit të Ujrave të Ndotura, fokusuar në ndërtimin e rrjetit sekondar dhe terciar. Investime do të fokusohen në Rrjetin e Kanalizimeve nëpërmjet të cilit synohet të përmirësohet dhe zgjidhet problemi i kanalizimit të ujërave të zeza të zonës së Durrësit, përfshirë dhe zonën e Plazhit.

Infrastruktura rrugore: Politikat e Bashkisë Durrës do të fokusohen në përmirësimin dhe rindërtimin e infrastrukturës rrugore nëpërmjet investimeve në 24 projekte. Gjatësi totale e rrugëve të brendshme parashikohet të jetë 75 km në të gjithë territorin e bashkisë.

KAPITULLI XII. ANALIZA E PRONAVE PUBLIKE& MARRËDHËNIET E PRONËSISË MBI TOKËN

Bazuar nga të dhënat e ALUIZNIT, Bashkia Durrës ka një sipërfaqe prej 1,420.00 ha në Zona Informale / Vendbanime Informale nga të cilat 1,157.6ha i përket NJA Durrës dhe 262.4 ha i përket NJA Rrashbull, ndërsa nëkatër NJA e tjera ka pak banesa informale pasi pjesa më e madhe e banesave është ndërtuar në tokë bujqësore, e cila rezulton të jetë tokë në pronësi të familjarit i cili ndërton në këtë sipërfaqe.

Sipas standardeve të miratuara nga IPV për objektet publike të Durrësit, parqet, qendrat rajonale konkretisht shëndetësore, ndërtesat administrative, objektet urbane ndahen në:

A) lokale, 38% të cilat i referohen një niveli lagjeje (domethënë kopshte në lagje, vende lokale të tregut, çerdhe, qendra sociale dhe kulturore)

B) urbane, 62% të cilat i referohen qytetit të tërë, (si varreza, thertore, biblioteka, muzeume, auditorë, teatro, qendra sportive, etj).

Tabela 16: Shkalla e përdorimit të territorit (në ha)

N r.	Rajoni	N J Q V	Sipërfaqe e transferuar ndare në:		
			Pyje, etj.	Kullota	Gjithsej
1	Durrës	Bashkia Manëz	1050		1050
2		Katundi i Ri	147.75		147.75
3		Sukth	265.2		265.2
4		Ishëm	4836.44	34.2	4870.64
5		Rrashbull	35	437.7	472.7
Total			6334.39	471.9	6806.29

Burimi: Bashkia Durrës, Llogaritjet e autoreve

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se, sipërfaqet e transferuara nga pushteti qëndror në atë lokal janë 6806.29 ha në total, të cilat ndahen në: a) sipërfaqe pyjore 6334.39 ha, dhe b) sipërfaqe kullota 471.9 ha (nga të dhënat vëmë re se NJA-të Manëz, Katundi i Ri dhe Sukth nuk kanë sipërfaqe kullota). Në funksion shkallës së përdorimit të tokës vihet re që sipërfaqet pyjore janë ato të cilat mund të trajtohen më së shumti nga Bashkia Durrës në funksion të zhvillimit të territorit të saj.

Tabela 17: Përdorimit të tokës publike në NJA Durrës.

Fushat e perdorimit te tokes	Lloji i pronesise	Sip.totale prones m2	Funksioni per te cilin perdoret prona
Strehim dhe Mbrojtje Civile	Truall dhe ndërtesë	43,304	Strehim
Administrata	Truall dhe ndërtesë	21,023	Administrata (zyra)
zyra,seli,rezidenca	Truall dhe ndërtesë	120,497	zyra,seli,rezidenca
sport, kulturë	Truall dhe ndërtesë	95,313	sport, kulturë
arsim, shkolla	Truall dhe ndërtesë	96,165	arsim, shkolla
Zhvillim Ekonomik	Truall dhe ndërtesë	147,757	zhvillim ekonomik
sherbime publike	Truall dhe ndërtesë	149,167	sherbime publike
godina publike	Truall dhe ndërtesë	2,151	godina publike
rruge	Rruge	952,382	rruge
hapsira publike	Sheshe, lulishte	4,910,639	hapsira publike
Ujitje - Kullim	Kanale ujitje, kullim	141,755	administrata ujitje - kullim
Mbrojtje	Sheshe, lulishte	717,850	Mbrojtje kombëtare, të ndryshme
Bujqesi	Troje, ara, pemishte	1,757,108	Troje, ara, pemishte, ullishte etj
Burime natyrore	V. Bregd.U.Territ.Rera	368,914,333	Zhvillim turizmi
Energjitike	Truall dhe ndërtesë	4,463	Transformim shperndarje energjie
Rezerva Shteterore	Truall dhe ndërtesë	86,370	Magazina, kapanone
Shendetsi	Truall dhe ndërtesë	43,036	Shëndeti paresor
Shendetesi	Truall dhe ndërtesë	4,513	Shëndeti paresor
Të tjera	Truall dhe ndërtesë	6,940	
TOTALI		378,214,765	

Burimi: Bashkia Durrës Llogaritjet e autoreve

Tabela 18: Vlera e Tokës sipas kategorive – Manzë, Sukth dhe Rrashbull

BASHKIA/KOMUNA	NJESI VENDORE/Fshatra	VLERA NDËRTESA (lek/m2)	VLERA TRUALLI (lek/m2)	VLERA TOKA BUJQËSOR E (lek/m2)	VLERA LIVADHE KULLOTA (lek/m2)	VLERA TOKA PYJORE (lek/m2)
BASHKIA MANZË	BASHKIA MANZË	40,400	786			
	ARMATH		739	408	177	21
	BORC		739	352	152	
	HAMALLAJ		369	447	194	
	KAMERAS		739	788	342	21
	KUCOK		2216	744	323	
	RADË		554	842	365	21
	SHKALLË		923	357	155	21
KOMUNA RRASHBULL	HARTE DËG		x	x	x	x
BASHKIA SUKTH	BASHK.SUKTH ZK 3542	41,500	2983	x	x	x
	VADADHË ZK 3690		647	339	151	x
	KULLË ZK 2321		x	339	151	x
	RRUSHKULL ZK 3241		2317	339	151	182
	HAMALLAJ ZK 1925		475	330	151	182

KAPITULLI XIII. ÇËSHTJET, ZONAT OSE OBJEKTET E RËNDËSISË KOMBËTARE

Zona e Lire Ekonomike – Spitalle (ZIS) ndodhet në veri të qytetit të Durrësit dhe është planifikuar të ketë një sipërfaqe prej 483.08 ha. Zhvillimi i kësaj zonë është pjesë integrale e zhvillimit të gjithë zonës ekonomiko-industriale të Durrësi të bazuar në dy portet: Durrës dhe Porto-Romano. ZIS ka potencial të shndërrojë Durrësin në një lider të aktivitetit ekonomik & industrial në përëndim të gadishullit Ballkanik.

Zona Industriale Rrashbull (ZIR) është miratuar me VKM Nr. 105, datë 09.02.2011, është shpallur Zonë e Lirë me Statusin e Parkut industrial. ZIR ka një sipërfaqe prej 16.52 ha, kohëzgjatja e koncesionit është për 35 vjet duke filluar nga viti 2012.

Zona Energjitike dhe Industriale Porto Romano (ZEIPR) zë një sipërfaqe prej 859 ha në tokat e ish-Kënetës është një zonë komplekse ku krahas terminalit bregdetar të import-eksport të produkteve të hidrokarbureve planifikohet dhe ndërtimi i TEC-ve, një impiant pastrimi, një mini-rafineri, si dhe objekte të tjera industriale.

Porti i Durrësit është porti më i rëndësishëm në Shqipëri me një sipërfaqe të përgjithshme prej 1.4 km² dhe një akuatorium prej 0.67 km². Në port funksionojnë 11 kalata operuese nga 6.6-11 m të thella me një gjatësi rreth 2,200 m. Sipërfaqja totale për depozitimin e mallrave është 270,000 m² nga të cilat 27,000 m² janë të mbuluara.

- Në portin e Durrësit ngarkohen dhe shkarkohen të gjitha llojet e mallrave mineralë, karburante, çimento dhe artikuj të kategorive të ndryshme. Aktualisht, në portin e Durrësit është dyfishuar numri i trageteve krahasuar më një vit më parë. Çdo javë në këtë port akostohen rreth 40 tragete dhe katamaranë që lidhin Durrësin me portet e tjera të Mesdheut. Terminali i konteniereve është në fazën ndërtimore. Përveç kalatës dhe sheshit që ka në dispozicion, në ndihmë të terminalit të konteniereve në portin e Durrësit ndodhen edhe një sërë pajisjesh që ndihmojnë në ngarkim-shkarkimin e tyre.
- Porti i Porto-Romanos shërben për ankorimin dhe shkarkimin e anijeve cisterne që sjellin hidrokarbure dhe gaz në terminalin e Portit. Së bashku me Petroliferën, Porto Romano është porti më i madh për hidrokarburet në Shqipëri nga ku shpërndahen shumica e produkteve të importuara që konsumohen në vend.

Zona e autostrades edhe pse ndodhet jashtë qytetit dhe në fushën e shkëmbimit të nivelit të autostradave të ndryshme, bie brenda kufirit të tij administrativ. Nga pika e parë e vendndodhjes, kjo zonë ka një vlerë shumë strategjike në lidhje me zhvillimin e aksit metropolitan mes Durrësit dhe Tiranës.

Amfiteatri romak ne Durrës është shpallur Monument Kulture në vitin 1973. Amfiteatri i Durrësit, më i madhi dhe me i rëndësishmi, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Ballkan, është ndërtuar në fillim të shekullit të I-rë të e.s., forumi i rëndësishëm bizantin që daton në mes të shekullit të IV dhe të VI pas Krishtit, disa pjesë të mureve të farit të erës Helenistike. Ai ka vlera të veçanta arkitekturore dhe artistike dhe, mund të krahasohet me monumentet e kësaj periudhe të Pompeit dhe Kapuas në Itali. Amfiteatri ka trajtë eklipsi me diametër 136 metra dhe

Iartësi rreth 20 m. Amfiteatri romak i Durrësit është ndërtuar në faqen lindore të kodrës me kuotë 59 m, në pjesën juglindore të kështjellës, në mes të harkut verior dhe jugperëndimor të mureve të saj.

Bazilika e Shën Mëhillit në Arapaj është një bazilikë tre nefesh paleokristine e ndërtuar në shekullin e VI, ndër më të mëdhatë të zbuluara në vendin tonë. Monumenti ka vazhduar të përdoret për një kohë të gjatë deri në shekullin e XV. Pas një dëmtimi të parë kisha rindërtohet duke u shtruar me tulla dhe më vonë pas djegies së saj nga normanët gjatë betejës që u zhvillua rreth Durrësit në 1081, ajo zvogëlohet shumë në përmasa duke u reduktuar në një kishë modeste në pjesën lindore të bazilikës.

KAPITULLI XIV. ANALIZA E ELEMENTËVE TË RËNDËSISHËM TERRITORIAL

Në analizën e elementëve territorial gjejmë dy koncepte si më poshtë:

XIV.1. Pozita e favorshme gjeografike

Bashkia Durrës ka pozitë të favorshme gjeografike dhe ndodhet në kryqezimin e rrugëve të mëdha tregtare. Ndër rrugët kryesore janë: Durrës-Ohër-Manastir-Sofje-Stamboll; Durrës-Elbasan-Korçë-Follorinë-Selanik. Durrësi ka rëndësi të madhe strategjike. Durrësi është i vendosur në brigjet e detit Adriatik rreth 33 km, në perëndim të kryeqytetit, Tiranës. Bashkia Durrës ndodhet në një nga pikat më të ngushta të Detit Adriatik përballë porteve italiane të Barit (300 km larg) dhe Brindisit. Sot, qyteti përhapet jashtë në vendbanimet e ndërtimeve në fushën nga lindja. Vendi është mjaft i ulët në jug në gjirin e Durrësit. Distancat janë 39 km larg nga Tirana; 30 km larg nga Aeroporti ndërkombëtar “NënëTereza”; 150 km larg nga pika kufitare me Malin e Zi (Hani i Hotit); 243 km larg nga pika kufitare me Kosovën (Morinë); 162 km larg nga pika kufitare me Maqedoninë (Qafë Thanë) dhe 184 km nga Tushemishti, si dhe 178 km larg nga Bllata.

XIV.1. Pozita e favorshme për zhvillim natyror

Mbështetur në analizën e situatës mjedisore në Bashkinë Durrës vihen re elemente të rëndësishëm me ndikim në territor si më poshtë:

- **Kodra e Kallmit:** parashikohet rritja e sipërfaqes së gjelbër transformim në kurorën e qytetit të Durrësit.
- **Brezi i lumit Erzen:** parashikohet eliminimi i ndotjeve urbane përgjatë (Sukth, Katundi i Ri, Rrushkull), mbrojtje dhe shtim i sipërfaqes së gjelbër.
- **Brezi bregdetar:** kërcënohet nga rreziku i lartë i rrëshqitjes së tokës si pasojë e mungesës së ekuilibrit hidro-gjeologjik të shkaktuar nga ngritja e këtyre ndërtesave të larta në shpatet e kepit bregdetar. Parashikohet përmirësimi i parametrave mjedisor, eliminimi i elementëve ndotës urban.
- **Rezervati natyror i Rrushkullit:** parashikohet konservim dhe rritje e hapsirave të gjelbërta.
- **Kodrat e Ishmit dhe Manzës:** parashikohet mbrojtje e parametrave ekzistues mjedisor, mbrojtje dhe shtim sipërfaqeve pyjore, kontroll i rritjes urbane në fshatrat kodrinor.
- **Zonat me rezikshmëri të lartë përmbetje:** Bashkia Durrës është një zonë që karakterizohet kryesisht nga një nivel i lartë përmbetjesh dhe kjo lidhet me specifikën që ka dhe vetë NJA Durrës. Zonat e rrezikuara në Durrës janë: a) i gjithë brezi përgjatë Erzenit, duke filluar nga pjesa perëndimore e kodrave të Shijakut dhe duke vazhduar duke u zgjeruar gradualisht në grykëderdhjen e lumit, rrezikohet nga fenomeni i përmbetjeve periodike. (Sukth-Katund i Ri) deri në Rrushkull, rrezikohet nga përmbetjet

periodike si pasoje e reshjeve; b) zona lindore e Durrësit (Kënetë, Spitallë) rezulton me nivel të lartë të ujërave nëntokësore; c) plazhet ranore të Rrashbullit, Durrësit dhe Gjirit të Lalzit rrezikojnë të zhduken nga veprimi i dyanshëm i ngritjes së nivelit të detit dhe erozionit të shkaktuar nga rrymat detare dhe ndërhyrjes së faktorit human.

- **Rreshqitjet e dheut:** Zona me e njohur është ajo e Currilave që vazhdon gjatë gjithë zonës së Kallmit. Por edhe zona e kreshtes kodrinore të Ishmit (Kertushaj, Likmetaj dhe Gjericaj) rezultojnë zona me rrezikshmeri gjeologjike të shkarjes, të ngjashme me zonën e Currilave.

KAPITULLI XV. ANALIZA E ELEMENTEVE PËRJASHTUES

Analiza e elementeve përjashtues¹³, është bazuar në normat dhe rregulloret ekzistuese për identifikimin e zonave të kufizuara. Duhet të theksohet që zonat e identifikuar si të kufizuara dhe kufizimet që kanë lidhje me to, janë “opsione të panegociueshme” për sa i përket mbrojtjes së mjedisit (përfshi menaxhimin e rrezikut për rreziqe potenciale mjedisore, siç janë përmbytjet, tërmetet, etj.), ruajtjes së pejsazhit dhe të aseteve të trashëgimisë kulturore.

Figurë x. Harta e zonave të kufizuara



Burimi IPV Durrës

Zonat me kufizime në Durrës janë të lidhura me basenet e ujit, varrezat, pikat e derdhjes së kanalizimeve, rezervuareve të ujit, vend-grumbullimet e plehrave (shih figurën më sipër). Kuptohet që sapo këto varreza, vendgrumbullime plehrash, etj., do të vendosen jashtë kufijve të qytetit edhe kufizimet që lidhen me to nuk do të ekzistojnë më.

- fund i dokumentit -

¹³ Informacioni bazohet në PPV Durrës 2013